FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 37

Tiranë – E mërkurë, 9 mars 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 16/2022, datë 10.2.2022	Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar	5585
Rezolutë e Kuvendit datë 7.3.2022	Për mbështetjen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës dhe Mbrojtjen e Parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare dhe të Sigurisë Evropiane	5585
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 27.2.2022	Për ndalimin e fluturimeve ajrore nga transportuesit ajrorë rusë në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë	5586
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 2.3.2022	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	5587
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 2.3.2022	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë	5589
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 2.3.2022	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit	5590
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 2.3.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 86, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese"	5590
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 2.3.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve, të rregullave e procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar	5592
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 2.3.2022	Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023–2025	5593

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 131, datë 2.3.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për njohjen reciproke të operatorëve ekonomikë të autorizuar–autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS).....	5599
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 2.3.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për njohjen reciproke të operatorëve ekonomikë të autorizuar–autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS).....	5602
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 133, datë 2.3.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga Sekretariati i Shtetit, për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë zvicerane, nën Fondin e Besimit me Shumë Donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për projektin e zhvillimit të kontabilitetit në sektorin publik, miratuar me vendimin nr. 251, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....	5605
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 2.3.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 577, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit 'Rikonstruksioni i rrugës 'Mujo Ulqinaku' (seg. i dytë) dhe rrugës 'Jakov Mile', Fier", të ndryshuar.....	5607
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 2.3.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 688, datë 14.11.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të objektit, me emërtim 'Oborr i Qendrës Spitalore Universitare 'Nënë Tereza", Tiranë".....	5609
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 136, datë 2.3.2022	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Arbas Hoxha....	5609
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 137, datë 2.3.2022	Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik *"Dreamades Luxury Suites"*.....	5610
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 2.3.2022	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin *"EU4CULTURE"*.....	5611
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 32/3, datë 2.3.2022	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar.....	5615
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 155, datë 2.3.2022	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 100, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, *fast food* dhe lokaleve", të ndryshuar.....	5615

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 23, datë 14.2.2022

Mbi miratimin e rregullores, mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit, për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit..... 5615

Kërkesë për shpalljen e faktit juridik të vdekjes së shtetases Aristulla Stamati..... 5622

LIGJ
Nr. 16/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8417, DATË 21.10.1998, "KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 83, pika 1, dhe 177, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, me propozimin e një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 179/ b, pika 8, në fjalinë e parë togfjalëshi "është 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit të tyre", zëvendësohet me togfjalëshin "përfundon në datën 31.12.2024".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 10.2.2022.

REZOLUTË

PËR MBËSHTETJEN E SOVRANITETIT DHE TËRËSISË TERRITORIALE TË UKRAINËS DHE MBROJTJEN E PARIMEVE TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE TË SIGURISË EVROPIANE

Duke u bazuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, në Aktin Final të Helsinkit dhe dokumentet e OSBE-së që e kanë pasuar atë, në Memorandumin e Budapestit të vitit 1994, për Garancitë e Sigurisë lidhur me aderimin e Ukrainës në Traktatin e Mospërhapjes së Armëve Bërthamore, në Marrëveshjet e Minskut të vitit 2014 dhe paketën e masave në zbatim të tyre, të nënshkruar në vitin 2015;

Duke shprehur shqetësim të thellë për faktin se vlerat e bashkëjetesës paqësore mes popujve, demokracia dhe të drejtat e njeriut, të promovuara në Evropë dhe në botë pas Luftës së Dytë Botërore, janë cenuar rendë nga agresioni ushtarak i Federatës Ruse kundër Ukrainës;

Në mbështetje të sovranitetit, tërësisë territoriale dhe zhvillimit demokratik të Ukrainës;

Në mbështetje të plotë të qëndrimit të vendeve të tjera në të gjithë botën, që aspirojnë e mbrojnë vlerat demokratike, në përputhje të plotë me politikën e përbashkët të jashtme e të sigurisë së Bashkimit Evropian, përfshirë vendimet e Bashkimit Evropian për masa shtrënguese;

Në respekt dhe nën përgjegjësinë e rolit të Shqipërisë si anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për periudhën 2022–2023;

Duke marrë në konsideratë rrezikun e ndikimit në rajonin tonë të agresionit rus në Ukrainë me pasojë demotivimin e perspektivës euroatlantike të rajonit për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Evropë;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Dënon me forcë agresionin ushtarak rus në Ukrainë dhe shkeljen e rëndë nga ana e Federatës Ruse të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës, si një akt që dhunon rendin ndërkombëtar, duke shkelur hapur dhe në mënyrë flagrante Kartën e Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit, Memorandumin e Budapestit, Marrëveshjet e Minskut, si dhe një sërë

dokumentesh të tjera ndërkombëtare dhe dypalëshe që Rusia ka firmosur me vullnet të lirë.

Nxit dhe mbështet veprimtarinë diplomatike dhe masat e marra nga qeveria shqiptare, në bashkërendim me aleatët tanë strategjikë, SHBA-të dhe BE-në, në mbështetje të sovranitetit të Ukrainës dhe të parimeve të sigurisë evropiane dhe rendit global të marrëdhënieve midis shteteve.

Mbështet sanksionet ekonomike, masat diplomatike të ndërmarra nga partnerët strategjikë ndaj Federatës Ruse, ndihmën ushtarake dhe humanitare për Ukrainën dhe popullin e saj.

Bën thirrje për ndalimin e menjëhershëm të përdorimit të forcës nga Federata Ruse në Ukrainë dhe për tërheqjen e forcave ushtarake ruse nga territori i Ukrainës sipas kufijve të njohur ndërkombëtarisht.

Dënon me forcë agresionin ushtarak rus ndaj Ukrainës, duke vlerësuar se aktet kundër civilëve të pafajshëm janë krime lufte dhe se shkaktarët e këtij agresioni duhet të përballen me Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Kuvendi i kërkon qeverisë që:

Të vazhdojë angazhimin në bashkërendim të ngushtë me të gjitha vendet aleate dhe partnere në NATO, BE, KS të OKB-së, OSBE, KiE, në rajonin e Ballkanit dhe me partnerë të tjerë, në mbështetje të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës dhe të parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të sigurisë evropiane.

Të forcojë me prioritet përpjekjet për integrimin evropian të vendit dhe rajonit, si mbështetje e pazëvendësueshme për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Evropë.

Miratuar në datën 7.3.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

VENDIM
Nr. 106, datë 27.2.2022

PËR NDALIMIN E FLUTURIMEVE AJRORE NGA TRANSPORTUESIT AJRORË RUSË NË HAPËSIRËN AJRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "ç", dhe 9, pikat 1 e 7, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndalimin e fluturimeve ajrore, përfshirë çdo avion të operuar nga transportuesit ajrorë rusë, duke përfshirë si transportues marketingu në marrëveshjet e ndarjes së kodit ose të hapësirës së bllokuar, për çdo avion të regjistruar në Rusi dhe për çdo avion jo të regjistruar në Rusi, i cili është në pronësi ose me qira, ose kontrollohet ndryshe nga çdo person fizik ose juridik, ent ose organ rus, lejeve për të ulur, për t'u ngritur nga ose për të fluturuar mbi territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Organet përgjegjëse mund të autorizojnë një avion të ulet, të ngrihet ose të fluturojë mbi territorin e Republikës së Shqipërisë nëse autoritetet kompetente kanë përcaktuar se një ulje, ngritje ose fluturim i tillë kërkohet për qëllime humanitare ose për çdo qëllim tjetër, në përputhje me objektivat e këtij vendimi.

3. Organet përgjegjëse do të refuzojnë të gjitha planet e fluturimit të paraqitura nga operatorët e avionëve, që tregojnë një synim për të kryer aktivitete mbi territorin e Republikës së Shqipërisë, që përbëjnë shkelje të dispozitave të këtij vendimi ose të masave të tjera të sigurisë dhe sigurisë në fuqi, në mënyrë që piloti të mos lejohet të fluturojë.

4. Ky vendim do të jetë në fuqi deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave të vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/335, të datës 28 shkurt 2022, i cili ndryshon vendimin (CFSP)2014/512, në lidhje me masat kufizuese, në përgjigje të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë.

5. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 110, datë 2.3.2022

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike. Ajo përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, të tregtisë, të strehimit dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik me synim rritjen ekonomike, të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Kjo ministri harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergjimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës e të shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen.

Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror.

3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) politikën makroekonomike dhe fiskale;
b) administrimin e të ardhurave;
c) administrimin e buxhetit të shtetit;
ç) menaxhimin e borxhit publik;
d) administrimin financiar;
dh) menaxhimin financiar dhe kontrollin;
e) menaxhimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian;
ë) inspektimin financiar publik;
f) bashkërendimin e përgjithshëm të auditimit të brendshëm;
g) fushën e strehimit;
gj) fushën e punësimit;
h) fushën e arsimit dhe formimit profesional;
i) fushën e sigurimeve shoqërore;
j) marrëveshjet e tregtisë së lirë;
k) nxitjen e investimeve;
l) administrimin e pronës shtetërore;
ll) mbështetjen e partneritetit publik privat;
m) fushën e regjistrimit dhe licencimit të operatorëve ekonomikë;
n) fushën e shërbimit të akreditimit dhe standardizimit;
nj) fushën e mirëmbajtjes, kalibrimit dhe inspektimit të mjeteve matëse;
o) fushën e pronësisë industriale;
p) fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale;
q) fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;
r) zonat ekonomike dhe teknologjike;
rr) parandalimin e pastrimit të parave dhe terrorizmit;
s) lojërat e fatit;
sh) ndihmën shtetërore dhe garancitë shtetërore.

4. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 3, të këtij vendimi, është përgjegjëse, për:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave fiskale, në të cilat përfshihen analizat makroekonomike, parashikimi i të ardhurave, politika e shpenzimeve publike, politika e taksave, politika e borxhit publik;

b) mbikëqyrjen dhe ndërmarrjen e nismave dhe hapave ligjorë, me qëllim administrimin e të ardhurave, në të cilat përfshihen, kryesisht, administrimi i taksave dhe administrimi doganor;

c) hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit, në të cilat përfshihen planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, kontrolli i menaxhimit të investimeve publike, monitorimi i marrëdhënieve financiare ndërqeveritare, kontrolli financiar i transaksioneve publike dhe hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë;

ç) menaxhimin e borxhit publik, në të cilin përfshihen menaxhimi i portofolit të huamarrjes së brendshme dhe të huaj, menaxhimi i riskut të huamarrjes, si dhe shërbimi i regjistrimit të borxhit;

d) ngritjen e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë e sektorit publik, nëpërmjet vendosjes së rregullave, standardeve, procedurave dhe monitorimit të zbatimit të tyre;

dh) miradministrimin financiar të fondeve publike, i cili realizohet nëpërmjet ushtrimit të funksionit të thesarit, zbatimit të metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik dhe kontrollit të brendshëm financiar publik;

e) menaxhimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian, sigurimin e bashkëfinancimit, ndjekjen e zbatimit të kontratave, legjitimitetin dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar, si dhe funksionimin e efektshëm të sistemeve të menaxhimit të kontrollit, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA);

ë) inspektimin financiar publik, si funksion i parashikuar me qëllim:

i. mbrojtjen e interesave financiare të njësive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit;

ii. rregullshmërinë e transaksioneve e të veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar publik;

iii. përcaktimin e shkeljeve të akteve normative, si dhe dyshimeve për mashtrimet e kryera;

iv. zbulimin e parregullsive e të dëmeve të shkaktuara në pronën e njësive publike;

v. identifikimin e shkeljeve e të individëve përgjegjës për parregullsitë e zbuluara;

f) zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e punësimit, në fushën e emigracionit dhe imigracionit të punës;

g) zhvillimin e politikave shtetërore për arsimin dhe formimin profesional;

gj) zhvillimin e politikave në fushën e marrëdhënieve të punës, inspektimit, sigurisë dhe shëndetit në punë;

h) zhvillimin e politikave dhe monitorimin e politikave, të legjislacionit e të veprimtarive që kanë të bëjnë me sigurimet shoqërore, si dhe procesin e bashkërendimit të punës për skemat e mbrojtjes shoqërore me vendet e tjera;

i) bashkërendimin institucional të procesit të negocimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe më gjerë;

j) hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike për mbrojtjen e biznesit vendas nga praktika të pandershme të tregtisë ndërkombëtare;

k) bashkërendimin e programimit, vlerësimit dhe monitorimit të investimeve të huaja, në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit;

l) ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga të qenët pronar i pronës shtetërore;

ll) krijimin e një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen, nëpërmjet nxitjes së biznesit dhe liberalizimit të tregut, duke reduktuar pengesat administrative dhe kostot e biznesit për eliminimin e informalitetit dhe korrupsionit, duke u mbështetur në partneritetin e vazhdueshëm publik privat;

m) zhvillimin e politikave në favor të biznesit të vogël dhe të mesëm, në përputhje me politikën përkatëse evropiane në bashkëpunim me dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit dhe shoqërinë civile;

n) ofrimin e shërbimit të regjistrimit dhe licencimit të operatorëve ekonomikë që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

nj) ofrimin e shërbimit të akreditimit për organizmat e vlerësimit të konformitetit;

o) përshtatjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit për përfitimet nga zbatimi i standardeve teknike në produktet dhe shërbimet e tyre;

p) zhvillimin dhe mirëmbajtjen e etaloneve kombëtare të njësive të matjes;

q) kalibrimin dhe verifikimin e mjeteve matëse;

r) realizimin e inspektimit metrologjik;

rr) propozimin e masave ligjore në fushën e pronësisë industriale;

s) regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale (patentat e shpikjeve, markat, dizenjot industriale dhe treguesit gjeografikë);

sh) mbrojtjen e pronësisë intelektuale;

t) mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e punës për politikat dhe veprimtaritë e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë (standardizimi, akreditimi dhe metrologjia);

th) mbikëqyrjen efektive të tregut për të garantuar përputhshmërinë e produkteve të konsumatorëve me kërkesat ligjore në lidhje me to, me qëllim që të mos rrezikohen shëndeti, siguria ose aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik;

u) bashkërendimin e punës për harmonizimin e legjislacionit në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe zbatimit të plotë të parimit të trajtimit kombëtar dhe mosdiskriminimit.

5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni i vetëm që bën bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm nëpërmjet hartimit dhe miratimit të politikave, manualeve, metodave, procedurave,

udhëzimeve dhe rregulloreve të auditit të brendshëm.

6. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka rol të përgjithshëm këshillues në interes të politikave qeveritare për promovimin e efektshmërisë, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare në të gjithë sektorin publik dhe në ato institucione financiare në të cilat qeveria merr pjesë.

7. Vendimi nr. 503, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë", shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 111, datë 2.3.2022

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin e zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare, si dhe në sektorin e industrisë.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha:

a) planifikimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm urban;

b) standardet urbane në ndërtim;

c) hartimi, zbatimi dhe ndjekja e politikave të zhvillimit të infrastrukturës, në të cilat përfshihen infrastruktura, transporti dhe ujësjellës-kanalizimet;

ç) drejtimi, menaxhimi, mbikëqyrja dhe vendosja e standardeve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, të porteve, aeroporteve, ujësjellës-kanalizimeve dhe të digave të mëdha të hidrocentraleve. Përcaktimi dhe vendosja e standardeve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit dhe organizimi i drejtimit të kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit;

d) monitorimi i realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës në transport, ujësjellës-kanalizime, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar e teknik;

dh) hartimi dhe zbatimi i monitorimit të trafikut rrugor, detar, ajror dhe hekurudhor përmes sistemeve inteligjente të vendosura në agjencitë, ndërmarrjet dhe drejtoritë e varësisë, për të garantuar sigurinë e çdo sektori të sipërpërmendur, në linjë me parimet ndërkombëtare. Sigurimi i kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operatorëve vendës e të huaj nëpërmjet sistemeve inteligjente, të përshtatshme për t'u përfshirë në sistemet evropiane të informacionit;

e) sektori i energjisë, i burimeve energjetike, përfshirë edhe burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe eficienca e energjisë;

ë) hartimi i politikave dhe strategjitë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike të ardhura si pasojë e veprimtarisë së fushave të përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

f) sektori i hidrokarbureve (naftë dhe gaz);

g) sektori i minierave dhe gjeologjisë;

gj) sektori i industrisë joushqimore;

h) telekomunikacioni dhe shërbimi postar.

4. Vendimi nr. 504, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 112, datë 2.3.2022

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka si mision hartimin e zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen nga ndryshimet klimatike, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin e zbatimin e politikave për turizmin.

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) sektori i mjedisit, përfshirë politikat, standardet e trajtimit të mbetjeve, si dhe monitorimin e kontrollin e efekteve që sjellin në drejtim të ajrit e të mjedisit, cilësia e ajrit, ndotja industriale, kimikatet, monitorimi i efekteve klimatike, monitorimi i kontrollit të treguesve të mjedisit e të cilësisë së ujërave, vlerësimi i ndikimit në mjedis;

b) natyra dhe biodiversiteti, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtja e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtja e peizazhit natyror, mbrojtja e faunës së egër e të specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura;

c) sektori i pyjeve dhe i kullotave;

ç) hartimi dhe zbatimi i politikave për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, të agroturizmit, ekoturizmit, turizmit ujor, zonave bregdetare, ngritjes, monitorimit e kontrollimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit të biznesit në fushën e turizmit, të promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit e bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor, si dhe ushtrimi i funksioneve të tjera, sipas legjislacionit përkatës, nëpërmjet institucioneve të varësisë, aparatit të ministrisë dhe degëve territoriale.

4. Vendimi nr. 509, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 120, datë 2.3.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 86, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ZALL-HERR, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" e "iv", dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Harta dhe koordinatat, që i bashkëlidhen vendimit nr. 86, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, përkatësisht, me hartën dhe koordinatat, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 129, datë 2.3.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 548, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, TË RREGULLAVE E PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 1, të vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në ndarjen e parë "Institucione kushtetuese e të pavarura", pas emërtesës "Avokati i Popullit", shtohen emërtesat e mëposhtme:

- Kolegji i Posaçëm i Apelimit;
- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
- Komisionerët Publikë;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

b) në ndarjen e dytë "Institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" hiqet emërtesa "Këshilli i Lartë i Drejtësisë" dhe shtohen emërtesat e mëposhtme:

- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Akademia e Shkencave;
- Instituti i Statistikave;

c) në ndarjen e tretë "Institucione në varësi të Kryeministrit" hiqen emërtesat e mëposhtme:

- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Akademia e Shkencave;
- Instituti i Statistikave.

2. Në lidhjen nr. 2, që përmendet në pikën 2, të vendimit, bëhen këto shtesa:

a) për "Grupin e parë", në pikën 8 bëhen shtesat e mëposhtme:

- në shkronjën "a" shtohen emërtesat "Kryetar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit" dhe "Kryetar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", "Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor", "Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë", "Komisioneri Publik" dhe "Drejtues i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar";
- në shkronjën "b" shtohen emërtesat: "Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", "Komisioner i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", "Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor", "Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë", "Inspektori i Lartë i Drejtësisë" dhe "Drejtor i Shkollës së Magjistraturës";

b) për "Grupin e dytë", në pikën 9 bëhen shtesat e mëposhtme:

- Në shkronjën "a" shtohen emërtesat: "Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", "Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", "Kancelar i Komisionerëve Publikë", "Sekretar i Përgjithshëm i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", "Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor", "Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë", "Magjistrat" dhe "Pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës";
- në shkronjën "a", në nënndarjen " ... dhe persona të tjerë të barazuar me ta, si më poshtë: ..." shtohet emërtesa "Kancelar në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar";
- në shkronjën "b" shtohet emërtesa: "Kryetar në Komisionin e Prokurimit Publik" dhe "Inspektor jomagjistrat në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë";
- në shkronjën "d" shtohen emërtesat: "Këshilltar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", "Këshilltar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", "Këshilltar i Komisionerit Publik", "Kancelar në Shkollën e Magjistraturës", "Nënkryetar dhe anëtarë në Komisionin e Prokurimit Publik".

II. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 130, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023–2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023–2025, sipas lidhjes nr. 1 "Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr.1

TAVANET INDIKATIVE - SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE (në 000/lek)

Kodi	Emërtimi i institucionit/programit	Viti 2023					Viti 2024					Viti 2025				
		Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	**Presidenca**	**248,000**	**6,000**	**0**	**6,000**	**254,000**	**248,500**	**6,000**	**0**	**6,000**	**254,500**	**248,500**	**6,000**	**0**	**6,000**	**254,500**
01120	Veprimtaria e Presidentit	248,000	6,000	0	6,000	254,000	248,500	6,000	0	6,000	254,500	248,500	6,000	0	6,000	254,500
2	**Kuvendi**	**1,148,566**	**48,000**	**0**	**48,000**	**1,196,566**	**1,148,566**	**48,000**	**0**	**48,000**	**1,196,566**	**1,148,566**	**48,000**	**0**	**48,000**	**1,196,566**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	432,640	48,000	0	48,000	480,640	432,640	48,000	0	48,000	480,640	432,640	48,000	0	48,000	480,640
01120	Veprimtaria ligjvënëse	715,926	0	0	0	715,926	715,926	0	0	0	715,926	715,926	0	0	0	715,926
3	**Kryeministria**	**400,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**450,000**	**426,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**476,000**	**426,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**476,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	400,000	50,000	0	50,000	450,000	426,000	50,000	0	50,000	476,000	426,000	50,000	0	50,000	476,000
5	**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	**6,774,000**	**3,079,272**	**3,360,260**	**6,439,532**	**13,213,532**	**6,905,000**	**2,827,272**	**2,198,731**	**5,026,003**	**11,931,003**	**6,925,000**	**2,931,863**	**2,198,731**	**5,130,594**	**12,055,594**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	318,000	7,000	0	7,000	325,000	320,000	5,000	0	5,000	325,000	320,000	5,000	0	5,000	325,000
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,541,000	95,409	161,529	256,938	1,797,938	1,570,000	95,409	0	95,409	1,665,409	1,550,000	100,000	0	100,000	1,650,000
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	690,000	**1,240,000**	0	1,240,000	1,930,000	700,000	**1,190,000**	0	1,190,000	1,890,000	800,000	**1,190,000**	0	1,190,000	1,990,000
04250	Zhvillimi rural duke mbësht. prodh., bujq., blek, agroind. dhe market.	**3,620,000**	1,616,863	2,529,308	4,146,171	7,766,171	3,660,000	1,416,863	1,529,308	2,946,171	6,606,171	3,660,000	1,516,863	1,529,308	3,046,171	6,706,171
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	450,000	20,000	0	20,000	470,000	460,000	20,000	0	20,000	480,000	450,000	20,000	0	20,000	470,000
05470	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	25,000	0	0	0	25,000	25,000	0	0	0	25,000	25,000	0	0	0	25,000
04230	Mbështetje për peshkimin	130,000	100,000	669,423	769,423	899,423	170,000	100,000	669,423	769,423	939,423	120,000	100,000	669,423	769,423	889,423
6	**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**	**5,244,900**	**27,016,294**	**17,759,755**	**44,776,049**	**50,020,949**	**5,411,500**	**29,593,640**	**20,134,749**	**49,728,389**	**55,139,889**	**5,617,400**	**31,162,549**	**22,934,749**	**54,097,298**	**59,714,698**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	515,100	13,000	0	13,000	528,100	550,100	13,000	0	13,000	563,100	550,100	13,000	0	13,000	563,100
04520	Transporti Rrugor	2,850,900	18,091,269	3,838,132	21,929,401	24,780,301	2,900,000	19,096,290	4,688,132	23,784,422	26,684,422	3,100,000	20,165,199	5,188,132	25,353,331	28,453,331
04540	Transporti Detar	110,000	58,630	10,000	68,630	178,630	120,000	50,000	10,000	60,000	180,000	120,000	50,000	10,000	60,000	180,000
04550	Transporti Hekurudhor	415,000	550,000	2,378,349	2,928,349	3,343,349	436,000	550,000	3,302,393	3,852,393	4,288,393	436,000	550,000	3,302,393	3,852,393	4,288,393
04560	Transporti Ajror	20,300	12,700	0	12,700	33,000	20,300	2,000	0	2,000	22,300	20,300	2,000	0	2,000	22,300
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	0	20,000	20,000	20,000	0	0	20,000	20,000	20,000	0	0	20,000	20,000	20,000
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	**455,000**	**7,320,472**	7,256,274	14,576,746	15,031,746	**460,000**	**8,923,602**	7,834,224	16,757,826	17,217,826	**460,000**	**9,423,602**	10,134,224	19,557,826	20,017,826
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	200,000	441,223	997,000	1,438,223	1,638,223	200,000	429,747	1,000,000	1,429,747	1,629,747	200,000	429,747	1,000,000	1,429,747	1,629,747
04320	Mbështetje për energjinë	102,000	250,000	3,260,000	3,510,000	3,612,000	102,000	250,000	3,280,000	3,530,000	3,632,000	102,000	250,000	3,280,000	3,530,000	3,632,000
04430	Mbështetje për burimet natyrore	230,000	91,000	0	91,000	321,000	230,000	97,000	0	97,000	327,000	230,000	97,000	0	97,000	327,000
04440	Mbështetje për industrinë	277,000	84,000	0	84,000	361,000	331,000	78,000	0	78,000	409,000	331,000	78,000	0	78,000	409,000
06180	Planifikimi Urban	69,600	104,000	0	104,000	173,600	62,100	104,000	0	104,000	166,100	68,000	104,000	0	104,000	172,000
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**	**62,133,350**	**1,621,769**	**2,088,000**	**3,709,769**	**65,843,119**	**65,432,650**	**1,569,689**	**2,870,690**	**4,440,379**	**69,873,029**	**67,772,650**	**1,569,689**	**3,370,690**	**4,940,379**	**72,713,029**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	526,000	148,000	350,000	498,000	1,024,000	630,000	148,000	400,000	548,000	1,178,000	630,000	148,000	400,000	548,000	1,178,000
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	378,000	0	0	0	378,000	405,000	0	0	0	405,000	405,000	0	0	0	405,000
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	500,000	0	0	0	500,000	500,000	0	0	0	500,000	500,000	0	0	0	500,000
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,600,000	295,080	0	295,080	2,895,080	2,700,000	83,000	0	83,000	2,783,000	2,750,000	83,000	0	83,000	2,833,000
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	3,800,000	123,220	120,690	243,910	4,043,910	3,820,000	123,220	120,690	243,910	4,063,910	3,930,000	123,220	120,690	243,910	4,173,910
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	85,000	2,000	0	2,000	87,000	85,000	2,000	0	2,000	87,000	85,000	2,000	0	2,000	87,000
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	310,000	72,000	150,000	222,000	532,000	610,000	82,000	150,000	232,000	842,000	610,000	82,000	150,000	232,000	842,000

Kodi	Emërtimi i institucionit/programit	Viti 2023					Viti 2024					Viti 2025				
		Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
04160	Mbështetje për mbikq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	338,000	22,000	0	22,000	360,000	338,000	22,000	0	22,000	360,000	338,000	22,000	0	22,000	360,000
10220	Sigurimi Shoqëror	48,601,350	0	0	0	48,601,350	51,179,650	0	0	0	51,179,650	53,059,650	0	0	0	53,059,650
10550	Tregu i punës	2,340,000	81,000	0	81,000	2,421,000	2,490,000	81,000	0	81,000	2,571,000	2,590,000	81,000	0	81,000	2,671,000
04170	Inspektimi në punë	180,000	10,000	0	10,000	190,000	190,000	10,000	0	10,000	200,000	190,000	10,000	0	10,000	200,000
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	2,165,000	418,469	567,310	985,779	3,150,779	2,170,000	468,469	400,000	868,469	3,038,469	2,370,000	468,469	400,000	868,469	3,238,469
06190	Strehimi	310,000	450,000	900,000	1,350,000	1,660,000	315,000	550,000	1,800,000	2,350,000	2,665,000	315,000	550,000	2,300,000	2,850,000	3,165,000
11	**Ministria e Arsimit dhe Sportit**	**39,930,000**	**4,334,000**	**220,000**	**4,554,000**	**44,484,000**	**41,682,634**	**4,834,000**	**220,000**	**5,054,000**	**46,736,634**	**42,852,634**	**5,034,000**	**220,000**	**5,254,000**	**48,106,634**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	708,000	55,000	0	55,000	763,000	710,000	55,000	0	55,000	765,000	760,000	55,000	0	55,000	815,000
09120	Arsimi bazë (përfshirë parashkolloriin)	22,175,000	1,437,000	0	1,437,000	23,612,000	23,204,134	1,537,000	0	1,537,000	24,741,134	23,524,134	1,637,000	0	1,637,000	25,161,134
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	6,540,000	1,162,000	0	1,162,000	7,702,000	6,660,000	1,362,000	0	1,362,000	8,022,000	6,960,000	1,462,000	0	1,462,000	8,422,000
09450	Arsimi universitar	10,000,000	1,130,000	100,000	1,230,000	11,230,000	10,600,000	1,330,000	100,000	1,430,000	12,030,000	11,000,000	1,330,000	100,000	1,430,000	12,430,000
09770	Fonde për Shkencën	381,000	250,000	100,000	350,000	731,000	382,000	250,000	100,000	350,000	732,000	432,000	250,000	100,000	350,000	782,000
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	126,000	300,000	20,000	320,000	446,000	126,500	300,000	20,000	320,000	446,500	176,500	300,000	20,000	320,000	496,500
12	**Ministria e Kulturës**	**1,806,500**	**2,250,000**	**0**	**2,250,000**	**4,056,500**	**1,760,000**	**1,750,000**	**0**	**1,750,000**	**3,510,000**	**1,840,000**	**1,750,000**	**0**	**1,750,000**	**3,590,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	172,500	0	0	0	172,500	180,000	0	0	0	180,000	180,000	0	0	0	180,000
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	638,500	7,500	0	7,500	646,000	620,000	7,500	0	7,500	627,500	630,000	7,500	0	7,500	637,500
08230	Arti dhe kultura	995,500	2,242,500	0	2,242,500	3,238,000	960,000	1,742,500	0	1,742,500	2,702,500	1,030,000	1,742,500	0	1,742,500	2,772,500
13	**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**	**73,106,028**	**1,901,700**	**1,110,000**	**3,011,700**	**76,117,728**	**72,662,428**	**2,101,700**	**1,110,000**	**3,211,700**	**75,874,128**	**73,269,328**	**2,101,700**	**1,110,000**	**3,211,700**	**76,481,028**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	330,000	18,000	0	18,000	348,000	360,000	18,000	0	18,000	378,000	440,000	18,000	0	18,000	458,000
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	8,500,000	92,000	158,000	250,000	8,750,000	8,550,000	192,000	158,000	350,000	8,900,000	8,070,900	192,000	158,000	350,000	8,420,900
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	30,667,000	1,473,020	852,000	2,325,020	32,992,020	31,238,000	1,573,020	852,000	2,425,020	33,663,020	31,744,000	1,573,020	852,000	2,425,020	34,169,020
07450	Shërbimet e Shëndetit Publik	5,214,428	13,680	0	13,680	5,228,108	3,664,428	13,680	0	13,680	3,678,108	3,664,428	13,680	0	13,680	3,678,108
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	359,600	125,000	0	125,000	484,600	400,000	125,000	0	125,000	525,000	400,000	125,000	0	125,000	525,000
10430	Përkujdesi Social	27,000,000	180,000	100,000	280,000	27,280,000	27,400,000	180,000	100,000	280,000	27,680,000	27,900,000	180,000	100,000	280,000	28,180,000
01190	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,035,000	0	0	0	1,035,000	1,050,000	0	0	0	1,050,000	1,050,000	0	0	0	1,050,000
14	**Ministria e Drejtësisë**	**11,104,400**	**391,000**	**110,000**	**501,000**	**11,605,400**	**11,794,400**	**471,000**	**110,000**	**581,000**	**12,375,400**	**12,099,400**	**471,000**	**110,000**	**581,000**	**12,680,400**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	454,000	141,800	110,000	251,800	705,800	441,000	141,800	110,000	251,800	692,800	441,000	141,800	110,000	251,800	692,800
03310	Ndihma Juridike	80,500	2,000	0	2,000	82,500	81,000	2,000	0	2,000	83,000	81,000	2,000	0	2,000	83,000
01120	Publikimet Zyrtare	56,500	13,000	0	13,000	69,500	57,500	13,000	0	13,000	70,500	57,500	13,000	0	13,000	70,500
01130	Mjekësia Ligjore	88,600	1,000	0	1,000	89,600	81,600	1,000	0	1,000	82,600	81,600	1,000	0	1,000	82,600
03440	Sistemi i Burgjeve	5,850,000	220,000	0	220,000	6,070,000	5,850,000	300,000	0	300,000	6,150,000	5,850,000	300,000	0	300,000	6,150,000
03350	Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor	154,000	5,000	0	5,000	159,000	159,000	5,000	0	5,000	164,000	164,000	5,000	0	5,000	169,000
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	15,000	200	0	200	15,200	15,000	200	0	200	15,200	15,000	200	0	200	15,200
01180	Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	4,250,000	6,000	0	6,000	4,256,000	4,950,000	6,000	0	6,000	4,956,000	5,250,000	6,000	0	6,000	5,256,000
03490	Shërbimi i Provës	155,800	2,000	0	2,000	157,800	159,300	2,000	0	2,000	161,300	159,300	2,000	0	2,000	161,300
15	**Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**	**2,967,349**	**73,999**	**80,780**	**154,779**	**3,122,128**	**2,953,000**	**74,000**	**80,780**	**154,780**	**3,107,780**	**3,010,000**	**74,000**	**80,780**	**154,780**	**3,164,780**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	271,573	37,999	0	37,999	309,572	283,000	38,000	0	38,000	321,000	283,000	38,000	0	38,000	321,000
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,393,776	15,000	0	15,000	2,408,776	2,359,000	15,000	0	15,000	2,374,000	2,410,000	15,000	0	15,000	2,425,000
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së	206,000	0	0	0	206,000	211,000	0	0	0	211,000	211,000	0	0	0	211,000
01150	Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit	96,000	21,000	80,780	101,780	197,780	100,000	21,000	80,780	101,780	201,780	106,000	21,000	80,780	101,780	207,780
16	**Ministria e Brendshme**	**19,822,000**	**830,000**	**460,077**	**1,290,077**	**21,112,077**	**19,938,000**	**800,000**	**0**	**800,000**	**20,738,000**	**20,063,000**	**800,000**	**0**	**800,000**	**20,863,000**

Kodi	Emërtimi i institucionit/programit	Viti 2023					Viti 2024					Viti 2025				
		Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,216,000	122,849	0	122,849	1,338,849	1,237,000	122,849	0	122,849	1,359,849	1,237,000	122,849	0	122,849	1,359,849
03140	Policia e Shtetit	15,830,000	562,151	460,077	1,022,228	16,852,228	15,900,000	512,151	0	512,151	16,412,151	15,950,000	512,151	0	512,151	16,462,151
03150	Garda e Republikës	1,780,000	10,000	0	10,000	1,790,000	1,800,000	30,000	0	30,000	1,830,000	1,800,000	30,000	0	30,000	1,830,000
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor	500,000	5,000	0	5,000	505,000	505,000	5,000	0	5,000	510,000	505,000	5,000	0	5,000	510,000
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	496,000	130,000	0	130,000	626,000	496,000	130,000	0	130,000	626,000	571,000	130,000	0	130,000	701,000
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**22,569,139**	**7,687,000**	**6,200,000**	**13,887,000**	**36,456,139**	**23,523,858**	**9,687,000**	**8,112,050**	**17,799,050**	**41,322,908**	**25,078,156**	**10,987,000**	**8,112,050**	**19,099,050**	**44,177,206**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,310,300	120,000	0	120,000	1,430,300	1,320,300	120,000	0	120,000	1,440,300	1,340,300	120,000	0	120,000	1,460,300
02120	Forcat e Luftimit	6,080,000	5,224,500	4,300,000	9,524,500	15,604,500	7,000,000	6,924,500	6,100,000	13,024,500	20,024,500	7,980,000	8,224,500	6,100,000	14,324,500	22,304,500
09430	Arsimi Ushtarak	720,000	350,000	0	350,000	1,070,000	750,000	457,000	0	457,000	1,207,000	755,000	457,000	0	457,000	1,212,000
02150	Mbështetja e Luftimit	6,852,839	1,222,500	0	1,222,500	8,075,339	6,797,558	1,265,500	0	1,265,500	8,063,058	7,266,856	1,265,500	0	1,265,500	8,532,356
07340	Mbështetje për Shëndetësinë	1,056,000	200,000	0	200,000	1,256,000	1,106,000	200,000	0	200,000	1,306,000	1,156,000	200,000	0	200,000	1,356,000
10270	Mbështetje Sociale për Ushtarakët	5,200,000	0	0	0	5,200,000	5,200,000	0	0	0	5,200,000	5,200,000	0	0	0	5,200,000
10910	Emergjencat Civile	1,350,000	570,000	1,900,000	2,470,000	3,820,000	1,350,000	720,000	2,012,050	2,732,050	4,082,050	1,380,000	720,000	2,012,050	2,732,050	4,112,050
18	**Shërbimi Informativ Shtetëror**	**1,825,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**1,875,000**	**1,840,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**1,890,000**	**1,840,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**1,890,000**
03520	Veprimtaria Informative Shtetërore	1,825,000	50,000	0	50,000	1,875,000	1,840,000	50,000	0	50,000	1,890,000	1,840,000	50,000	0	50,000	1,890,000
19	**Drejtoria e Radio Televizionit**	**570,000**	**0**	**0**	**0**	**570,000**	**570,000**	**0**	**0**	**0**	**570,000**	**570,000**	**0**	**0**	**0**	**570,000**
08310	Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit	240,000	0	0	0	240,000	240,000	0	0	0	240,000	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	200,000	0	0	0	200,000	200,000	0	0	0	200,000	200,000	0	0	0	200,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	68,000	0	0	0	68,000	68,000	0	0	0	68,000	68,000	0	0	0	68,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH-së dhe Kinematografisë	62,000	0	0	0	62,000	62,000	0	0	0	62,000	62,000	0	0	0	62,000
20	**Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave**	**191,000**	**15,000**	**0**	**15,000**	**206,000**	**192,000**	**15,000**	**0**	**15,000**	**207,000**	**192,000**	**15,000**	**0**	**15,000**	**207,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	191,000	15,000	0	15,000	206,000	192,000	15,000	0	15,000	207,000	192,000	15,000	0	15,000	207,000
22	**Akademia e Shkencës**	**127,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**128,500**	**109,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**110,500**	**109,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**110,500**
01520	Veprimtaria Akademike	127,500	1,000	0	1,000	128,500	109,500	1,000	0	1,000	110,500	109,500	1,000	0	1,000	110,500
24	**Kontrolli i Lartë i Shtetit**	**449,000**	**15,000**	**3,000**	**18,000**	**467,000**	**469,000**	**15,000**	**0**	**15,000**	**484,000**	**469,000**	**15,000**	**0**	**15,000**	**484,000**
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH-së	449,000	15,000	3,000	18,000	467,000	469,000	15,000	0	15,000	484,000	469,000	15,000	0	15,000	484,000
26	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	**1,368,000**	**507,100**	**390,000**	**897,100**	**2,265,100**	**1,394,000**	**507,100**	**390,000**	**897,100**	**2,291,100**	**1,394,000**	**357,100**	**390,000**	**747,100**	**2,141,100**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	196,000	3,000	0	3,000	199,000	202,000	3,000	0	3,000	205,000	202,000	3,000	0	3,000	205,000
05320	Programe për mbrojtjen e Mjedisit	453,000	90,000	390,000	480,000	933,000	451,000	90,000	390,000	480,000	931,000	451,000	90,000	390,000	480,000	931,000
04260	Administrimi i Pyjeve	335,000	98,600	0	98,600	433,600	356,000	98,600	0	98,600	454,600	356,000	98,600	0	98,600	454,600
04760	Zhvillimi i Turizmit	384,000	315,500	0	315,500	699,500	385,000	315,500	0	315,500	700,500	385,000	165,500	0	165,500	550,500
28	**Prokuroria e Përgjithshme**	**2,240,000**	**130,000**	**0**	**130,000**	**2,370,000**	**2,243,800**	**130,000**	**0**	**130,000**	**2,373,800**	**2,243,800**	**130,000**	**0**	**130,000**	**2,373,800**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	2,240,000	130,000	0	130,000	2,370,000	2,243,800	130,000	0	130,000	2,373,800	2,243,800	130,000	0	130,000	2,373,800
29	**Këshilli i Lartë Gjyqësor**	**3,372,700**	**250,000**	**0**	**250,000**	**3,622,700**	**3,381,650**	**250,000**	**0**	**250,000**	**3,631,650**	**3,381,650**	**200,000**	**0**	**200,000**	**3,581,650**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	295,200	15,000	0	15,000	310,200	297,150	15,000	0	15,000	312,150	297,150	15,000	0	15,000	312,150
01140	Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë	8,500	0	0	0	8,500	8,500	0	0	0	8,500	8,500	0	0	0	8,500
03310	Buxheti Gjyqësor	3,069,000	235,000	0	235,000	3,304,000	3,076,000	235,000	0	235,000	3,311,000	3,076,000	185,000	0	185,000	3,261,000
30	**Gjykata Kushtetuese**	**154,500**	**4,000**	**0**	**4,000**	**158,500**	**159,500**	**4,000**	**0**	**4,000**	**163,500**	**159,500**	**4,000**	**0**	**4,000**	**163,500**
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	154,500	4,000	0	4,000	158,500	159,500	4,000	0	4,000	163,500	159,500	4,000	0	4,000	163,500
31	**Agjencia Telegrafike Shqiptare**	**58,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**59,500**	**68,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**69,500**	**68,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**69,500**
08320	Veprimtaria telegrafike e ATSH-së	58,500	1,000	0	1,000	59,500	68,500	1,000	0	1,000	69,500	68,500	1,000	0	1,000	69,500

Kodi	Emërtimi i institucionit/programit	Viti 2023					Viti 2024					Viti 2025				
		Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
35	**Këshilli i Lartë I Prokurorisë**	**145,000**	**10,000**	**0**	**10,000**	**155,000**	**149,000**	**10,000**	**0**	**10,000**	**159,000**	**149,000**	**10,000**	**0**	**10,000**	**159,000**
01110	Veprimtaria e KLP-së	145,000	10,000	0	10,000	155,000	149,000	10,000	0	10,000	159,000	149,000	10,000	0	10,000	159,000
40	**Partitë Politike**	**355,800**	0	**0**	**0**	**355,800**	**355,800**	**0**	**0**	**0**	**355,800**	**355,800**	**0**	**0**	**0**	**355,800**
01110	Mbështetje për partitë politike	345,600	0	0	0	345,600	345,600	0	0	0	345,600	345,600	0	0	0	345,600
01120	Mbështetje për shoqatat	8,000	0	0	0	8,000	8,000	0	0	0	8,000	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbështetje për organizatat e veteranëve me status	2,200	0	0	0	2,200	2,200	0	0	0	2,200	2,200	0	0	0	2,200
41	**Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**	**1,010,000**	**20,000**	**0**	**20,000**	**1,030,000**	**1,020,000**	**20,000**	**0**	**20,000**	**1,040,000**	**1,020,000**	**20,000**	**0**	**20,000**	**1,040,000**
01110	Veprimtaria e SPAK-ut	1,010,000	20,000	0	20,000	1,030,000	1,020,000	20,000	0	20,000	1,040,000	1,020,000	20,000	0	20,000	1,040,000
50	**Instituti i Statistikës**	**560,000**	**15,600**	**0**	**15,600**	**575,600**	**550,000**	**15,600**	**0**	**15,600**	**565,600**	**550,000**	**15,600**	**0**	**15,600**	**565,600**
01320	Veprimtaria statistikore	560,000	15,600	0	15,600	575,600	550,000	15,600	0	15,600	565,600	550,000	15,600	0	15,600	565,600
55	**Shkolla e Magjistraturës**	**290,000**	**4,000**	**0**	**4,000**	**294,000**	**293,000**	**5,000**	**0**	**5,000**	**298,000**	**293,000**	**5,000**	**0**	**5,000**	**298,000**
09820	Veprimtaria arsimore	290,000	4,000	0	4,000	294,000	293,000	5,000	0	5,000	298,000	293,000	5,000	0	5,000	298,000
56	**Fondi i Zhvillimit Shqiptar**	**0**	**9,500,000**	**5,635,128**	**15,135,128**	**15,135,128**	**0**	**9,000,000**	**4,960,000**	**13,960,000**	**13,960,000**	**0**	**9,000,000**	**7,780,000**	**16,780,000**	**16,780,000**
06210	Programe Zhvillimi	0	5,000,000	5,635,128	10,635,128	10,635,128	0	4,500,000	4,960,000	9,460,000	9,460,000	0	4,500,000	7,780,000	12,280,000	12,280,000
06220	Infrastruktura vendore dhe rajonale	0	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	1,000,000	0	1,000,000	1,000,000	0	1,000,000	0	1,000,000	1,000,000	0	1,000,000	0	1,000,000	1,000,000
57	**Qendra Kombëtare e Kinematografisë**	**157,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**158,000**	**161,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**162,000**	**161,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**162,000**
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	157,000	1,000	0	1,000	158,000	161,000	1,000	0	1,000	162,000	161,000	1,000	0	1,000	162,000
63	**Institucionet e sistemit të drejtësisë**	**648,900**	**57,500**	**0**	**57,500**	**706,400**	**588,900**	**7,500**	**0**	**7,500**	**596,400**	**648,900**	**7,500**	**0**	**7,500**	**656,400**
03320	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	200,000	52,000	0	52,000	252,000	180,000	2,000	0	2,000	182,000	200,000	2,000	0	2,000	202,000
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	194,200	2,000	0	2,000	196,200	174,200	2,000	0	2,000	176,200	194,200	2,000	0	2,000	196,200
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	184,000	2,000	0	2,000	186,000	164,000	2,000	0	2,000	166,000	184,000	2,000	0	2,000	186,000
03360	Veprimtaria e Komisionerit Publik	70,700	1,500	0	1,500	72,200	70,700	1,500	0	1,500	72,200	70,700	1,500	0	1,500	72,200
66	**Avokati i Popullit**	**125,500**	**2,000**	**0**	**2,000**	**127,500**	**125,500**	**2,000**	**0**	**2,000**	**127,500**	**125,500**	**2,000**	**0**	**2,000**	**127,500**
03320	Shërbimi i Avokatisë	125,500	2,000	0	2,000	127,500	125,500	2,000	0	2,000	127,500	125,500	2,000	0	2,000	127,500
67	**Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**	**61,800**	**2,000**	**0**	**2,000**	**63,800**	**62,800**	**2,000**	**0**	**2,000**	**64,800**	**62,800**	**2,000**	**0**	**2,000**	**64,800**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	61,800	2,000	0	2,000	63,800	62,800	2,000	0	2,000	64,800	62,800	2,000	0	2,000	64,800
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**196,000**	**1,500**	**0**	**1,500**	**197,500**	**196,000**	**1,500**	**0**	**1,500**	**197,500**	**196,000**	**1,500**	**0**	**1,500**	**197,500**
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	196,000	1,500	0	1,500	197,500	196,000	1,500	0	1,500	197,500	196,000	1,500	0	1,500	197,500
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
76	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	**162,600**	**3,000**	**0**	**3,000**	**165,600**	**162,600**	**3,000**	**0**	**3,000**	**165,600**	**162,600**	**3,000**	**0**	**3,000**	**165,600**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	162,600	3,000	0	3,000	165,600	162,600	3,000	0	3,000	165,600	162,600	3,000	0	3,000	165,600
77	**Autoriteti i Konkurrencës**	**74,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**75,000**	**78,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**79,000**	**78,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**79,000**
04120	Mbikëqyrja e tregut & garantimi i konkurrencës	74,000	1,000	0	1,000	75,000	78,000	1,000	0	1,000	79,000	78,000	1,000	0	1,000	79,000
82	**Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit**	**13,700**	**1,000**	**0**	**1,000**	**14,700**	**13,800**	**1,000**	**0**	**1,000**	**14,800**	**13,800**	**1,000**	**0**	**1,000**	**14,800**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	13,700	1,000	0	1,000	14,700	13,800	1,000	0	1,000	14,800	13,800	1,000	0	1,000	14,800
87	**Institucione të tjera Qeveritare**	**6,372,657**	**1,229,266**	**243,000**	**1,472,266**	**7,844,923**	**6,463,123**	**1,551,000**	**243,000**	**1,794,000**	**8,257,123**	**6,863,123**	**1,551,000**	**243,000**	**1,794,000**	**8,657,123**
01320	Shërbime qeveritare	250,000	30,000	0	30,000	280,000	250,000	30,000	0	30,000	280,000	250,000	30,000	0	30,000	280,000
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	62,800	1,000	0	1,000	63,800	63,800	1,000	0	1,000	64,800	63,800	1,000	0	1,000	64,800
05640	Administrimi i ujërave	99,500	10,000	93,000	103,000	202,500	100,500	10,000	93,000	103,000	203,500	100,500	10,000	93,000	103,000	203,500
03310	Shërbimi i Avokatisë Shtetërore	218,400	2,000	0	2,000	220,400	219,400	2,000	0	2,000	221,400	228,400	2,000	0	2,000	230,400

Kodi	Emërtimi i institucionit/programit	Viti 2023					Viti 2024					Viti 2025				
		Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
01150	Shërbime të tjera	745,200	60,000	0	60,000	805,200	757,800	35,000	0	35,000	792,800	757,800	35,000	0	35,000	792,800
01140	e-Qeverisja	4,371,257	1,012,266	0	1,012,266	5,383,523	4,442,123	1,359,000	0	1,359,000	5,801,123	4,842,123	1,359,000	0	1,359,000	6,201,123
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	379,000	63,000	100,000	163,000	542,000	379,000	63,000	100,000	163,000	542,000	370,000	63,000	100,000	163,000	533,000
08610	Mbështetje për rininë dhe fëmijët	112,000	50,000	50,000	100,000	212,000	115,000	50,000	50,000	100,000	215,000	115,000	50,000	50,000	100,000	215,000
08480	Mbështetje për kultet fetare	134,500	1,000	0	1,000	135,500	135,500	1,000	0	1,000	136,500	135,500	1,000	0	1,000	136,500
88	**Mbështetje për Shoqërinë Civile**	**122,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**123,000**	**124,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**125,500**	**124,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**125,500**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	122,000	1,000	0	1,000	123,000	124,500	1,000	0	1,000	125,500	124,500	1,000	0	1,000	125,500
89	**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**71,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**72,000**	**71,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**72,000**	**71,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**72,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	71,000	1,000	0	1,000	72,000	71,000	1,000	0	1,000	72,000	71,000	1,000	0	1,000	72,000
90	**Veprimtaria e komisionit të prokurimit publik**	**72,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**73,000**	**74,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**75,000**	**74,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**75,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	72,000	1,000	0	1,000	73,000	74,000	1,000	0	1,000	75,000	74,000	1,000	0	1,000	75,000
91	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**53,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**54,000**	**54,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**55,500**	**54,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**55,500**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	53,000	1,000	0	1,000	54,000	54,500	1,000	0	1,000	55,500	54,500	1,000	0	1,000	55,500
92	**Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit**	**37,960**	**1,000**	**0**	**1,000**	**38,960**	**37,960**	**1,000**	**0**	**1,000**	**38,960**	**37,960**	**1,000**	**0**	**1,000**	**38,960**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	37,960	1,000	0	1,000	38,960	37,960	1,000	0	1,000	38,960	37,960	1,000	0	1,000	38,960
95	**Autoriteti për të drejtën e Informimit nga dosjet e ish-sigurimit**	**95,651**	**2,000**	**0**	**2,000**	**97,651**	**95,600**	**2,000**	**0**	**2,000**	**97,600**	**95,600**	**2,000**	**0**	**2,000**	**97,600**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	95,651	2,000	0	2,000	97,651	95,600	2,000	0	2,000	97,600	95,600	2,000	0	2,000	97,600
TOTALI		268,235,000	61,117,000	37,660,000	98,777,000	367,012,000	274,991,569	65,413,000	40,430,000	105,843,000	380,834,569	281,915,667	68,386,500	46,550,000	114,936,500	396,852,167

VENDIM
Nr. 131, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË, PËR NJOHJEN RECIPROKE TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË AUTORIZUAR – AUTORIZIMET PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN (OEAS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për njohjen reciproke të operatorëve ekonomikë të autorizuar – autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË, PËR NJOHJEN RECIPROKE TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË AUTORIZUAR – AUTORIZIMET PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN (OEAS)"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Serbisë (në vijim të referuar si "Palët");

duke marrë parasysh rëndësinë e kontributit të lehtësimit të tregtisë në zhvillimin ekonomik;

duke vendosur të eliminojnë pengesat në tregtinë e tyre të ndërsjellë dhe të krijojnë në mënyrë progresive marrëdhënie më të ngushta tregtare;

duke theksuar rolin e procesit të harmonizimit të BE-së në nxitjen e njohjes së ndërsjellë të Programeve të OEA-së;

duke vendosur që të forcojnë marrëdhëniet tregtare-ekonomike dhe mirëkuptimin e ndërsjellë ndërmjet Palëve;

duke marrë parasysh se Palët janë të vendosura që të përmirësojnë sigurinë në lëvizjen e mallrave që hyjnë ose dalin nga territoret e Shtetit të tyre, pa ndërprerë flukset tregtare;

duke pranuar që Programet OEA zbatojnë kërkesat e sigurisë në përputhje me ligjet përkatëse të Shteteve të Palëve, si dhe me standardet e njohura ndërkombëtarisht të sigurisë dhe të pajtueshmërisë të përcaktuara në "Kuadrin SAFE të Standardeve për Sigurimin dhe Lehtësimin e Tregtisë Globale" (në vijim i referuar si "Kuadri SAFE");

kanë rënë dakord për sa më poshtë.

Neni 1
Objekti i zbatimit të Marrëveshjes dhe autoritet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për operatorët ekonomikë të autorizuar për sigurinë dhe mbrojtjen (në vijim të referuar si "OEAS"), të cilëve iu është dhënë autorizim, sipas Programit OEA në Shtetet e Palëve.

Në Shtetin e secilës Palë, OEAS-i do të gëzojë lehtësira, në lidhje me kontrollet doganore të përmendura në nenet 5 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje.

Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- në Republikën e Serbisë: Ministria e Financave – Administrata Doganore (në vijim të referuara si "autoritetet doganore").

Neni 2
Njohja e ndërsjellë e autorizimeve të lëshuara të OEAS-it

Në përputhje me këtë Marrëveshje, autoritetet doganore të Shteteve të Palëve do të njohin reciprokisht autorizimet e lëshuara të OEAS-it, me

kusht që legjislacioni dhe zbatimi i Programit OEA të Shteteve të Palëve të jenë plotësisht në përputhje me *Acquis* në fuqi. Harmonizimi dhe statusi i zbatimit të Programit OEA të Shtetit të njërës Palë do të konfirmohen nga autoriteti doganor i Shtetit të Palës tjetër, pas përfundimit të një procesi vleftësimi.

Neni 3
Pajtueshmëria në zbatimin e Programit OEA

Sa më poshtë, garantohen në Shtetin e secilës Palë:

a) standardet e zbatuara për secilin Program të OEA-s duhet të jenë të zbatueshme, në lidhje me:

- kriteret e zbatimit;
- procesin e vleftësimit; dhe
- procesin e miratimit;
- menaxhimin e statusit të dhënë (monitorimi, rivlerësimi, ndryshimi, pezullimi dhe shfuqizimi).

b) Autoriteti doganor i Shtetit të secilës Palë do të realizojë Programin e tij OEA, në përputhje me parimet dhe standardet e Kuadrit SAFE.

Neni 4
Dhënia e statusit

Kriteret për dhënien e statusit të OEAS-it janë si më poshtë:

a) mungesa e ndonjë shkeljeje të rëndë ose shkeljeve të përsëritura të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore, përfshirë mospasjen e të dhënave për vepra të rënda penale, në lidhje me aktivitetin ekonomik të aplikantit;

b) demonstrimi i një niveli të lartë kontrolli nga aplikanti për veprimet e tij ose të saj dhe për lëvizjen e mallrave, me anë të një sistemi menaxhimi të të dhënave tregtare dhe, sipas rastit, të transportit, i cili mundëson kontrollet e duhura doganore;

c) aftësia paguese financiare, e cila do të konsiderohet e provuar kur aplikanti ka gjendje të mirë financiare, i mundëson atij ose asaj që të përmbushë angazhimet e tij ose të saj, duke marrë parasysh llojin e aktivitetit të biznesit në fjalë;

d) standardet e duhura të sigurisë dhe të mbrojtjes, të cilat do të konsiderohen të përmbushura, kur aplikanti provon se ai ose ajo ruan masat e duhura për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, përfshirë në fushat e integritetit fizik dhe kontrolleve të aksesit, proceseve logjistike dhe trajtimit të llojet specifike të mallrave, personelin dhe identifikimin e partnerëve të tij/saj të biznesit.

Neni 5
Përfitimet për OEAS-in në lidhje me deklaratën para nisjes

Kur një OEAS paraqet në emër të vet personal, një deklaratë para nisjes në formën e një deklarate doganore ose rieksporti, nuk do të kërkohen të dhëna të tjera, përveç atyre të përcaktuara në ato deklarata. Kur një OEAS paraqet në emër të një personi tjetër, i cili është gjithashtu OEAS, një deklaratë para nisjes në formën e një deklarate doganore ose rieksporti, nuk kërkohen të dhëna të tjera, përveç atyre të përcaktuara në ato deklarata.

Neni 6
Trajtimi më i favorshëm për OEAS-in, në lidhje me kontrollin dhe vlerësimin e riskut

OEAS-i do t'u nënshtrohet më pak kontrolleve fizike dhe dokumentuese se sa operatorë të tjerë ekonomikë.

Kur një OEAS ka paraqitur një deklaratë përmbledhëse hyrëse ose një deklaratë të ruajtjes së përkohshme ose kur një OEAS ka paraqitur njoftim dhe ka dhënë akses në të dhënat që lidhen me deklaratën përmbledhëse hyrëse në sistemin e tij kompjuterik, zyra doganore e hyrjes së parë, ku ngarkesa është përzgjedhur për kontroll fizik, do të njoftojë OEAS-in për këtë fakt. Ky njoftim do të bëhet përpara mbërritjes së mallrave në territorin doganor të Shtetit të Palës.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni i vihet në dispozicion edhe transportuesit, nëse ai është i ndryshëm nga OEAS-i, i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, me kusht që transportuesi të jetë OEAS dhe të jetë i lidhur me sistemet elektronike, që lidhen me deklaratat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni nuk do të jepet, nëse mund të rrezikojë kontrollet që do të kryhen ose rezultatet e tyre.

Kur një OEAS paraqet deklaratë për ruajtjen e përkohshme ose deklaratë doganore përpara paraqitjes së mallrave, zyra doganore kompetente për të marrë atë deklaratë për ruajtjen e

përkohshme ose atë deklaratë doganore përpara paraqitjes së mallrave, kur ngarkesa është përzgjedhur për kontroll doganor, do të njoftojë OEAS-in për këtë fakt. Ky njoftim do të bëhet përpara paraqitjes së mallrave në Doganë.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 5 të këtij neni nuk do të jepet, nëse mund të rrezikojë kontrollet që do të kryhen ose rezultatet e tyre. Kur ngarkesat e deklaruara nga një OEAS janë përzgjedhur për kontroll fizik ose dokumentues, këto kontrolle do të kryhen me përparësi.

Me kërkesë nga një OEAS, kontrollet mund të kryhen në një vend të ndryshëm nga vendi ku mallrat duhet të paraqiten në Doganë.

Njoftimet e përmendura në paragrafët 2 dhe 5 të këtij neni nuk lidhen me kontrollet doganore të lidhura me deklaratën e ruajtjes së përkohshme ose një deklaratë doganore pas paraqitjes së mallrave.

Neni 7
Përjashtimi nga trajtimi i favorshëm

Trajtimi më i favorshëm i përmendur në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje nuk do të zbatohet për kontrollet doganore që lidhen me nivele specifike të ngritura të rrezikut ose detyrime kontrolli të përcaktuara në legjislacion tjetër.

Neni 8
Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Palëve

Një autoritet doganor i Shtetit të secilës Palë, në rrethana të arsyeshme, mund të pezullojë një ose disa masa të lehtësimit të tregtisë së OEAS, të dhëna nga Shteti i Palës tjetër. Pezullimi ose trajtimi i tillë duhet t'i komunikohen me shkrim autoritetit doganor të Shtetit të Palës tjetër, brenda 5 (pesë) ditësh pune pas miratimit të vendimit për pezullimin e trajtimit të favorshëm, duke bazuar arsyet, sipas rastit.

Autoritetet doganore të Shteteve të Palëve do të informojnë rregullisht njëra-tjetrën për OEAS-in e tyre dhe do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

1. Numrin e identifikimit të OEAS-it;
2. Emrin dhe adresën e OEAS-it;
3. Numrin e dokumentit që jep statusin e OEAS-it;
4. Statusin aktual (aktiv, i pezulluar, i shfuqizuar);
5. Periudhat e statusit të ndryshuar;
6. Datën nga e cila autorizimi ka efekt ligjor; dhe
7. Autoritetin lëshues.

Palët mund të shkëmbejnë më shumë të dhëna se sa ato të specifikuara në paragrafin e mësipërm, siç mund të bien dakord, sipas legjislacionit të tyre kombëtar.

Mënyra e shkëmbimit të informacionit, sistemet që do të përdoren dhe periudha e informimit do të përcaktohen në Protokollin e përmendur në nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9
Mbrojtja e sekreteve profesionale dhe e të dhënave personale

Të dhënat e shkëmbyera nga autoritetet doganore të Shteteve të Palëve do të gëzojnë mbrojtjen e dhënë për sekretin profesional dhe të dhënat personale, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës të zbatueshëm në territorin e Shtetit të Palës marrëse.

Të dhënat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni nuk do t'u transferohen personave të ndryshëm nga autoriteti doganor kompetent i Shtetit të Palës në fjalë dhe as nuk do të përdoren nga ai autoritet, për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje.

Neni 10
Konsultimet

Palët do të kërkojnë të zgjidhin çdo mosmarrëveshje, në lidhje me çështjet dhe shqetësimet e lidhura me këtë Marrëveshje nëpërmjet konsultimeve. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim nga Palët.

Neni 11
Zbatimi i Marrëveshjes

Autoritetet doganore të Shteteve të Palëve do të lidhin një Protokoll, që përcakton metodën e kryerjes së procesit të vleftësimit të njohjes së ndërsjellë të OEAS-it, përpara fillimit të procesit të vleftësimit dhe aspekteve të tjera të nevojshme.

Neni 12
Dispozita përfundimtare

Kjo Marrëveshje do t'u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni kombëtar i Shtetit të secilës Pale. Secila Pale do të njoftojë Palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se procedura e nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje është përmbushur.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës në të cilën Pala tjetër ka marrë njoftimin e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni. Kjo Marrëveshje do të zbatohet pas kryerjes së procesit të vleftësimit në Shtetet e të dyja Palëve, në përputhje me nenin 2, paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë, më 21 dhjetor 2021, në dy kopje, në gjuhët shqipe, serbe, dhe angleze, ku të tria tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, në lidhje me interpretimin, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SERBISË

VENDIM
Nr. 132, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR NJOHJEN RECIPROKE TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË AUTORIZUAR–AUTORIZIMET PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN (OEAS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, datë 21.4.2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për njohjen reciproke të operatorëve ekonomikë të autorizuar–autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT "PËR NJOHJEN RECIPROKE TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË AUTORIZUAR–AUTORIZIMET PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN (OEAS)"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në vijim të referuar si "Palët"):

duke marrë parasysh rëndësinë e kontributit të lehtësimit të tregtisë në zhvillimin ekonomik;

duke vendosur të eliminojnë pengesat në tregtinë e tyre të ndërsjellë dhe të krijojnë në mënyrë progresive marrëdhënie më të ngushta tregtare;

duke theksuar rolin e procesit të harmonizimit të BE-së në nxitjen e njohjes së ndërsjellë të programeve të QEA;

duke vendosur që të forcojnë marrëdhëniet tregtare-ekonomike dhe mirëkuptimin e ndërsjellë ndërmjet Palëve;

duke marrë parasysh se Palët janë të vendosura që të përmirësojnë sigurinë në lëvizjen e mallrave që hyjnë ose dalin nga territoret e Shtetit të tyre, pa ndërprerë flukset tregtare;

duke pranuar që Programet OEA zbatojnë kërkesat e sigurisë në përputhje me ligjet përkatëse të Shteteve të Palëve, si dhe me standardet e njohura ndërkombëtarisht të sigurisë dhe të pajtueshmërisë të përcaktuara në "Kuadrin SAFE të Standardeve për Sigurimin dhe Lehtësimin e Tregtisë Globale" (në vijim i referuar si "Kuadri SAFE"),

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Objekti i zbatimit të Marrëveshjes dhe autoritetet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për operatorët ekonomikë të autorizuar për sigurinë dhe mbrojtjen (në vijim të referuar si "OEAS"), të cilëve iu është dhënë autorizim sipas Programit OEA në Shtetet e Palëve.

Në Shtetin e secilës Palë, OEAS-ja do të gëzojë lehtësira në lidhje me kontrollet doganore të përmendura në nenet 5 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje.

Autoritetet kompetente, për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, janë:

- në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Ministria e Financave – Administrata Doganore

(në vijim të referuara si "autoritetet doganore").

Neni 2
Njohja e ndërsjellë e autorizimeve të lëshuara të OEAS-së

Në përputhje me këtë Marrëveshje, autoritetet doganore të Shteteve të Palëve do të njohin reciprokisht autorizimet e lëshuara të OEAS-së, me kusht që legjislacioni dhe zbatimi i Programit OEA të Shteteve të Palëve të jenë plotësisht në përputhje me *acquis* në fuqi.

Harmonizimi dhe statusi i zbatimit të Programit OEA të Shtetit të njërës Palë do të konfirmohen nga autoriteti doganor i Shtetit të Palës tjetër, pas përfundimit të një procesi vlerësimi.

Neni 3
Pajtueshmëria në zbatimin e Programit OEA

Sa më poshtë garantohen në Shtetin e secilës Palë:

a) standardet e zbatuara për secilin Program të OEA-s duhet të jenë të zbatueshme në lidhje me:

- kriteret e zbatimit;
- procesin e vleftësimit; dhe
- procesin e miratimit;
- menaxhimin e statusit të dhënë (monitorimi, rivlerësimi, ndryshimi, pezullimi dhe shfuqizimi);

b) autoriteti doganor i Shtetit të secilës Palë do të realizojë Programin e tij OEA në përputhje me parimet dhe standardet e Kuadrit SAFE.

Neni 4
Dhënia e statusit

Kriteret për dhënien e statusit të OEAS-së janë si më poshtë:

a) mungesa e ndonjë shkeljeje të rëndë ose shkeljeve të përsëritura të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore, përfshirë mospasjen e të dhënave për vepra të rënda penale në lidhje me aktivitetin ekonomik të aplikantit;

b) demonstrimi i një niveli të lartë kontrolli nga aplikanti për veprimet e tij ose të saj dhe për lëvizjen e mallrave, me anë të një sistemi menaxhimi të të dhënave tregtare dhe sipas rastit, të transportit, i cili mundëson kontrollet e duhura doganore;

c) aftësia paguese financiare, e cila do të konsiderohet e provuar kur aplikanti ka gjendje të mirë financiare, i mundëson atij ose asaj që të përmbushë angazhimet e tij ose të saj, duke marrë parasysh llojin e aktivitetit të biznesit në fjalë;

d) standardet e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat do të konsiderohen të përmbushura kur aplikanti provon se ai ose ajo ruan masat e duhura për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, përfshirë në fushat e integritetit fizik dhe kontrolleve të aksesit, proceseve logjistike dhe trajtimit të llojet specifike të mallrave, personelin;

dhe identifikimin e partnerëve të tij/saj të biznesit.

Neni 5
Përfitimet për OEAS-n në lidhje me deklaratën para nisjes

Kur një OEAS paraqet në emër të vet personal një deklaratë para nisjes në formën e një deklarate doganore ose rieksporti, nuk do të kërkohen të dhëna të tjera përveç atyre të përcaktuara në ato deklarata.

Kur një OEAS paraqet në emër të një personi tjetër, i cili është, gjithashtu, OEAS, një deklaratë para nisjes në formën e një deklarate doganore ose

rieksporti, nuk kërkohen të dhëna të tjera përveç atyre të përcaktuara në ato deklarata.

Neni 6
Trajtimi më i favorshëm për OEAS në lidhje me kontrollin dhe vlerësimin e riskut

OEAS-ja do t'i nënshtrohet më pak kontrolleve fizike dhe dokumentuese sesa operatorë të tjerë ekonomikë.

Kur një OEAS ka paraqitur një deklaratë përmbledhëse hyrëse ose një deklaratë të ruajtjes së përkohshme ose kur një OEAS ka paraqitur njoftim dhe ka dhënë akses në të dhënat që lidhen me deklaratën përmbledhëse hyrëse në sistemin e tij kompjuterik, zyra doganore e hyrjes së parë ku ngarkesa është përzgjedhur për kontroll fizik, do të njoftojë OEAS-in për këtë fakt. Ky njoftim do të bëhet përpara mbërritjes së mallrave në territorin doganor të Shtetit të Palës.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni i vihet në dispozicion edhe transportuesit, nëse ai është i ndryshëm nga OEAS-ja i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, me kusht që transportuesi të jetë OEAS dhe të jetë i lidhur me sistemet elektronike që lidhen me deklaratat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni nuk do të jepet, nëse mund të rrezikojë kontrollet që do të kryhen ose rezultatet e tyre.

Kur një OEAS paraqet deklaratë për ruajtjen e përkohshme ose deklaratë doganore përpara paraqitjes së mallrave, zyra doganore kompetente për të marrë atë deklaratë për ruajtjen e përkohshme ose atë deklaratë doganore përpara paraqitjes së mallrave, kur ngarkesa është përzgjedhur për kontroll doganor, do të njoftojë OEAS-in për këtë fakt. Ky njoftim do të bëhet përpara paraqitjes së mallrave në Doganë.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 5 të këtij neni nuk do të jepet, nëse mund të rrezikojë kontrollet që do të kryhen ose rezultatet e tyre.

Kur ngarkesat e deklaruara nga një QEAS janë përzgjedhur për kontroll fizik ose dokumentues, këto kontrolle do të kryhen me përparësi.

Me kërkesë nga një OEAS, kontrollet mund të kryhen në një vend të ndryshëm nga vendi ku mallrat duhet të paraqiten në Doganë.

Njoftimet e përmendura në paragrafët 2 dhe 5 të këtij neni nuk lidhen me kontrollet doganore të lidhura me deklaratën e ruajtjes së përkohshme ose një deklaratë doganore pas paraqitjes së mallrave.

Neni 7
Përjashtimi nga trajtimi i favorshëm

Trajtimi më i favorshëm i përmendur në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje nuk do të zbatohet për kontrollet doganore që lidhen me nivele specifike të ngritura të rrezikut ose detyrime kontrolli të përcaktuara në legjislacion tjetër.

Neni 8
Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Palëve

Një autoritet doganor i Shtetit të secilës Palë, në rrethana të arsyeshme, mund të pezullojë një ose disa masa të lehtësimit të tregtisë të OEAS, të dhëna nga Shteti i Palës tjetër. Pezullimi ose trajtimi i tillë duhet t'i komunikohen me shkrim autoritetit doganor të Shtetit të Palës tjetër brenda 5 (pesë) ditësh pune pas miratimit të vendimit për pezullimin e trajtimit të favorshëm, duke bazuar arsyet, sipas rastit.

Autoritetet doganore të Shteteve të Palëve do të informojnë rregullisht njëra-tjetrën për OEAS-in e tyre dhe do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

1. numrin e identifikimit të OEAS;
2. emrin dhe adresën e OEAS;
3. numrin e dokumentit që jep statusin e OEAS;
4. statusin aktual (aktiv, i pezulluar, i shfuqizuar);
5. periudhat e statusit të ndryshuar;
6. datën nga e cila autorizimi ka efekt ligjor; dhe
7. autoritetin lëshues.

Palët mund të shkëmbejnë më shumë të dhëna sesa ato të specifikuara në paragrafin e mësipërm, siç mund të bien dakord sipas legjislacionit të tyre kombëtar.

Mënyra e shkëmbimit të informacionit, sistemet që do të përdoren dhe periudha e informimit do të përcaktohen në protokollin të përmendur në nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9
Mbrojtja e sekreteve profesionale dhe të dhënave personale

Të dhënat e shkëmbyera nga autoritetet doganore të Shteteve të Palëve do të gëzojnë

mbrojtjen e dhënë për sekretin profesional dhe të dhënat personale, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës të zbatueshëm në territorin e Shtetit të Palës marrëse.

Të dhënat e përmendura në paragrafin I të këtij neni nuk do ti transferohen personave të ndryshëm nga autoriteti doganor kompetent i Shtetit të Palës në fjalë dhe as nuk do të përdoren nga ai autoritet për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje.

Neni 10
Konsultimet

Palët do të kërkojnë të zgjidhin çdo mosmarrëveshje në lidhje me çështjet dhe shqetësimet e lidhura me këtë Marrëveshje nëpërmjet konsultimeve.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim nga Palët.

Neni 11
Zbatimi i Marrëveshjes

Autoritetet doganore të Shteteve të Palëve do të lidhin një protokoll që përcakton metodën e kryerjes së procesit të vleftësimit të njohjes së ndërsjellë të OEAS përpara fillimit të procesit të vleftësimit dhe aspekteve të tjera të nevojshme.

Neni 12
Dispozita përfundimtare

Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni kombëtar i Shtetit të secilës Palë.

Secila Palë do të njoftojë Palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se procedura e nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje është përmbushur.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës në të cilën Pala tjetër ka marrë njoftimin e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

Kjo Marrëveshje do të zbatohet pas kryerjes së procesit të vleftësimit në shtetet e të dyja palëve, në përputhje me nenin 2, paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë, më 21 dhjetor 2021, në dy kopje në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, ku të tria tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT

VENDIM
Nr. 133, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH, TË LETËRMARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA SEKRETARIATI I SHTETIT, PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE (SECO) TË QEVERISË ZVICERANE, NËN FONDIN E BESIMIT ME SHUMË DONATORË, PËR FUQIZIMIN E KONTABILITETIT DHE MJEDISIT TË MIRËBESIMIT NË EVROPËN JUGORE DHE AZINË QENDRORE, PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË KONTABILITETIT NË SEKTORIN PUBLIK, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 251, DATË 9.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të

siguruara nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë zvicerane, nën Fondin e Besimit me Shumë Donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për projektin e zhvillimit të kontabilitetit në sektorin publik, miratuar me vendimin nr. 251, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Logo **BANKA BOTËRORE**
BNRZH – IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienë, Austri, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

22 dhjetor 2021

Sh. s. znj. Delina Ibrahimaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
SHQIPËRI

E nderuar znj. Ministre,

Shqipëri - Projekti i Zhvillimit të Kontabilitetit të Sektorit Publik
Granti SAFE nr. TFOA3277 dhe Granti SAFE nr. TF0A5134
Zgjatja e afatit të mbylljes së projektit

I referohemi letërmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), i cili vepron si administrator i fondeve të grantit të ofruar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të Qeverisë Zvicerane (Donatori) nën Fondin e Mirëbesimit me Shumë Donatorë për Forcimin e Përgjegjshmërisë dhe Mjedisit të Besimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, të datës 3 prill 2018 për Projektin e Zhvillimit të Kontabilitetit të Sektorit Publik (Projekti) dhe letrës suaj të datës 26 qershor 2020, duke kërkuar nga Banka Botërore zgjatjen e afatit të mbylljes së grantit të mësipërm të parashikuar, sipas letërmarrëveshjes nga 31 dhjetor 2021 në 31 dhjetor 2022.

Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 31 dhjetor 2022, si datë të mëvonshme për qëllimet e nenit III, 3.03 të aneksit të letërmarrëveshjes.

Me respekt,

(Nënshkrimi)
Linda Van Gelder
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

Për dijeni:Znj. Adela Xhemali, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Z. Patrik Meier, zëvendësdrejtues i Misionit, Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të Qeverisë Zvicerane

Znj. Veronika Korkaj, Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Majlinda Dhuka, zëvendëssekretare e Përgjithshme dhe Drejtore e Përgjithshme e Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisjen

Z. Matteo Bugamelli, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

Tel.: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701

VENDIM
Nr. 134, datë 2.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 577, DATË 3.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS 'MUJO ULQINAKU' (SEG. I DYTË) DHE RRUGËS 'JAKOV MILE', FIER", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 577, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, shifra "4 006 581(katër milionë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një)" zëvendësohet me shifrën "4 844 557 (katër milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë)".

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 4 844 557 (katër milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

- 4 006 581 (katër milionë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë, nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë;
- 837 976 (tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, nga buxheti i Bashkisë Fier.".

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Fier.

3. Tabela, që i bashkëlidhet vendimit nr. 577, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Fier dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT: "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM NR. 577, DATË 3.8.2016, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI 'RIKONSTRUKSION I RRUGËS 'MUJO ULQINAKU' (SEG. I DYTË) DHE RRUGËS 'JAKOV MILE', FIER", TË NDRYSHUAR

Nr.	*Emër/atësia/mbiemër*	*Zona kadastrale*	*Nr. i pasurisë*	*Lloji i pasurisë*	*Sipërfaqe e përgjithshme e truallit (m²)*	*Sipërfaqe shpronësimi*	*Çmimi*	*Vlera e tokës truall (lekë)*	*Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m²)*	*Sip. e prekur e ndërtesës (m²)*	*Amortizimi (%)*	*Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)*	*Vlera totale/ lekë*	*Shënime*
						Tokë truall (m²)	*Tokë truall /m²*							
1	Sokol Nazmi Mecaj	8533	7/996	truall+ ndërtesë	177	177	11,026	1,951,602.00	48.00	48.00	30%	1,007,509	2,959,111	Konfirmuar nga ZVPP-ja
2	Kostandin Jani Boçova; Leonora Jani Shkurta; Theodhor Jani Boçova; Zhaneta Jani Mone; Virgjina Jani Petani; Sofie Jani Kule; Vasillaq Jani Boçova; Arsino Jani Boçova	8533	7/929	truall	400	51.5	11,026.00	567,839.00	-	-	-	-	567,839.00	Konfirmuar nga ASHK-ja; pezullohen veprimet, shpronësuar me VKM nr. 577, datë 3.8.2016
3	Halime Shateri e të tjerë	8533	7/257	85	85	11,026	937,210	-	-	-	-	937,210	937,210	Konfirmim nga ZVPP-ja
4	Kafaze Arif Saliaj; Ilmi Nazif Saliaj; Altin Nazif Saliaj; Fatmir Nazif Saliaj	8533	6/502	truall+ ndërtesë	445	34.5	11,026.00	380,397.00	-	-	-	-	380,397.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT													**4,844,557.00**	

Shënime.

Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë";

Vlerësimi i objektit "ndërtesë" është bërë në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.

VENDIM
Nr. 135, datë 2.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 688, DATË 14.11.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË OBJEKTIT, ME EMËRTIM "OBORR I QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE 'NËNË TEREZA', TIRANË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c" , të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 688, datë 14.11.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

i. Shkronja "a" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) 25 (njëzet e pesë) % kalojnë në llogarinë e qendrës spitalore universitare 'Nënë Tereza', Tiranë, prej të cilave:

i. 3 (tre) % përdoren për edukimin në vazhdim të burimeve njerëzore të kësaj qendre;

ii. 22 (njëzet e dy) % përdoren për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera.".

ii. Në shkronjën "b", shifra "42%" zëvendësohet me "20%".

b) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

"4/1. Të ardhurat e krijuara që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit dhe të papërdorura kalojnë 80% si të ardhura dytësore në buxhetin e QSUT-së për t'u përdorur për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera dhe 20% do të përdoren nga FSHZH-ja me kërkesë të QSUT-së dhe pas miratimit paraprak të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në infrastrukturë, për përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, në përmbushje të objektivave dhe të misionit.".

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe qendra spitalore universitare "Nënë Tereza", Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 136, datë 2.3.2022

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË FËMIJËS ARBAS HOXHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", dhe të vendimit nr. 43, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2022", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Arbas Hoxha, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 137, datë 2.3.2022

PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE DHE TË ZONËS PËRKATËSE TË PLAZHIT PËRBALLË KOMPLEKSIT, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK *"DREAMADES LUXURY SUITES"*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik "*Dreamades Luxury Suites*", Gjilekë, Himarë, i cili me vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar, ka përfituar statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar".

2. Afati për përdorimin e brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, sipas këtij vendimi, të jetë 30 (tridhjetë) vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Bashkia Himarë ka detyrimin që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik "*AGTTC Hotel Management*" sh.p.k, me NUIS M11825022K, të lidhë kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në përputhje me sipërfaqet e destinacionin e kërkuar nga subjekti, të lejuara me vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar, dhe të konfirmuara më tej nga Bashkia Himarë.

4. Investitori strategjik "*AGTTC Hotel Management*" sh.p.k., me NUIS M11825022K, duhet të paraqesë pranë Bashkisë Himarë kërkesën dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Plan-vendosjen e sipërfaqes, për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore;

b) Përshkrimin e aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen, për të cilën kërkon të lidhë kontratë.

5. Përdorimi i brigjeve dhe i zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror, të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi për turizmin, përkundrejt pagesës së tarifës, në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë. Kjo tarifë të aplikohet vetëm për sipërfaqen objekt kontrate, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të lidhur me Bashkinë Himarë, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

6. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Himarë.

7. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik "*AGTTC Hotel Management*" sh.p.k., me NUIS M11825022K, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar, dhe në përputhje me përcaktimet e kontratës përkatëse, që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Himarë.

8. Ngarkohet Bashkia Himarë për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik, në zbatim të këtij vendimi dhe të vendimit nr. 3/5, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar. Në këtë kontratë të parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimet e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimet e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik, si dhe penalitetet përkatëse. Kontrata për dhënien me qira të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, me koordinata sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, nën juridiksion të Bashkisë Himarë, të ketë afat një periudhë 30-vjeçare, me kusht që investitori të mos ndryshojë destinacionin e pronës (përfshirë, por pa u kufizuar, ndërtimin, dhënien me qira palëve të treta).

9. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Himarë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
KOORDINATAT PËR PROJEKTIN
"*DREAMADES LUXURY SUITES*"

Nr.	E	N
1	466117.732	4447249.372
2	466208.253	4447206.331
3	466232.327	4447291.596
4	466191.371	4447312.090
5	466142.297	4447329.018
6	466134.095	4447305.995
7	466136.943	4447304.911

VENDIM
Nr. 138, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PROJEKTIN *"EU4CULTURE"*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin *"EU4CULTURE",* sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NË SHQIPËRI

Znj. Elva Margariti
Ministre
Ministria e Kulturës
Tiranë – Shqipëri

Tiranë, 20 shtator 2021
Ares (2021) 5740733

Lënda: Programi *EU4 Culture* – Notë Verbale e Qeverisë së Shqipërisë

E nderuar ministre Margariti,

Në kuadër të Programit të Kulturës EU4, UNOPS-i ka kërkuar mbështetjen e delegacionit të BE-së për të iniciuar procesin, në lidhje me përjashtimin e TVSH-së për aktivitetet e programit.

Menduam se qasja që do të ndiqet mund të jetë e ngjashme me atë të zbatuar nga Qeveria e Shqipërisë për programin *EU4 Schools*, sepse të dyja programet si *EU4 Schools* dhe *EU4 Culture* janë pjesë e së njëjtës paketë të ofruar nga BE-ja për të mbështetur procesin e rindërtimit pas tërmetit të nëntorit 2019.

Siç është rënë dakord për projektin *EU4 Schools*, ne po ia drejtojmë këtë notë qeverisë së Shqipërisë, duke propozuar parimet e mëposhtme, të cilat u ranë dakord fillimisht ndërmjet palëve me nismën e Qeverisë së Shqipërisë për *EU4Schools*, zbatimi i të cilave do të garantojë suksesin e projektit, duke shkuar përtej përjashtimeve fiskale:

1. Projekti do të zbatohet në koordinim të plotë me Qeverinë e Shqipërisë dhe administratën publike.

2. Prokurimi, ndërtimi dhe zbatimi i projektit do të realizohen nga UNOPS-i, në përputhje me standardet shqiptare dhe të BE-së.

3. Veprimtaritë e ndërtimit dhe zbatimit do të mbikëqyren nga UNOPS-i dhe rezultatet do t'i dorëzohen Ministrisë së Kulturës.

4. Të gjitha detyrimet e palëve të treta në kantiere dhe të gjitha detyrimet ligjore mbeten përgjegjësi e autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht Ministrisë së Kulturës.

5. Problemet e zonave dhe të pronësisë, nëse ka, në lidhje me tokat, do të zgjidhen nga organet kompetente.

6. Ministria e Kulturës dhe/ose Bashkitë do të ofrojnë dokumentacionin e nevojshëm (lejet, licencat e autorizimit etj.) për zbatimin e punimeve.

7. Granti që siguron burimet për zbatimin e projektit, u nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, për përjashtimet përkatëse fiskale, si përjashtimi i TVSH-së, gjatë ekzekutimit të kontratës, në kuadër të procesit të rindërtimit nga fatkeqësitë natyrore.

8. Ministria e Kulturës merr përsipër të iniciojë dhe të ndjekë me Këshillin e Ministrave nënshkrimin e një vendimi të Këshillit të Ministrave, për programin *EU4 Culture*, për të zyrtarizuar notat e shkëmbyera dhe marrëveshjen e arritur.

9. Ministria e Kulturës merr përsipër të ndjekë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të sigurojë se do të lehtësojë menjëherë proceset e përjashtimit të TVSH-së me furnizuesit UNOPS.

Do të isha mirënjohës, nëse mund të konfirmoni dakordësinë tuaj me parimet e lartpërmendura, duke iu përgjigjur kësaj letre.

Një shkëmbim i tillë letrash mes nesh do të përbëjë një marrëveshje zyrtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, në lidhje me programin *EU4Culture,* i cili do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Bashkimi Evropian të njoftimit me shkrim nga pala shqiptare.

LUIGI SORECA

Bashkëlidhur: VKM-ja nr. 804, 30 shtator 2020 dhe nr. 635, 29 korrik 2020.

Për dijeni: Z. Arben Ahmetaj, zëvendëskryeministër, ministër Shteti për Programin e Reformave dhe Rindërtimit

Znj. Delina Ibrahimaj, zëvendëskryeministër e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Pamela Lama**,** drejtore lokale e Zyrës UNOPS

BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NË SHQIPËRI

Znj. Elva Margariti
Ministre
Ministria e Kulturës
Tiranë – Shqipëri

Tiranë, 13.10.2021
Ares (2021) 5740733

Lënda: Programi *EU4 Culture* - Notë Verbale e Qeverisë së Shqipërisë

Referenca: Nota Verbale e Bashkimit Evropian, 20 shtator 2021

Kthim përgjigje e Ministrisë së Kulturës, 1 tetor 2021

E nderuar ministre Margariti**,**

Më lejoni t'ju falënderoj për fillimin e procesit të përjashtimit nga TVSH-ja për aktivitetet e programit *EU4 Culture.*

Pas sqarimeve që ndatë me ne në përgjigjen tuaj të datës 1 tetor 2021, ne kemi rishikuar pikat e mëposhtme, si më poshtë:

1. Të gjitha detyrimet e TVSH-së dhe detyrime të tjera tatimore të palëve të treta në kantieret e ndërtimit dhe të gjitha detyrimet ligjore do të mbeten përgjegjësi e autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë.

2. Ministria e Kulturës dhe/ose bashkitë do të lehtësojnë procedurat për UNOPS-in, kur aplikojnë që të marrin dokumentacionin e nevojshëm (lejet, licencat e autorizimit etj.) për zbatimin e punimeve.

Në vijim të kërkesës suaj, lutemi gjeni bashkëlidhur listën e monumenteve të dakordësuara/në diskutim që të jenë pjesë e programit të kulturës EU4.

Në pritje të përfundimit të procesit.

LUIGI SORECA

Bashkëlidhur: Lista e siteve për Programin *EU4 Culture*.

Për dijeni: Z. Arben Ahmetaj, zëvendëskryeministër, ministër Shteti për Programin e Reformave dhe Rindërtimit

Znj. Delina Ibrahimaj**,** zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Pamela Lama, drejtore lokale e Zyrës UNOPS

Tiranë, 2.11.2021

LISTA E SITEVE ME PREVENTIVË

Në cilësinë e anëtarëve të Komitetit Drejtues të Projektit për projektin *EU4Culture* – Rivitalizimi i Trashëgimisë Kulturore të Shqipërisë në Përgjigje të Tërmetit në Shqipëri të vitit 2019, ne po miratojmë një listë të vendeve, të propozuara për t'iu nënshtruar ndërhyrjeve konservuese dhe rivitalizuese.

Lista e preventivëve për ndërhyrjet në secilin prej siteve.

Siti/kontrata	Vlerësimi (EURO)	TVSH (EURO)	TOTALI (EURO)
Shërbimet Konsultative të Dizajnit	1,176,100.00	235,220.00	1,411,320.00
Planet e menaxhimit të trashëgimisë kulturore	485,000.00	97,000.00	582,000.00
Materiali dokumentues	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Krijimi i përmbajtjes për interpretim	1,000,000.00	200,000.00	1,200,000.00
Komunikime, evente	400,000.00	80,000.00	480,000.00
Shërbimet dhe produktet e vizibilitetit	200,000.00	40,000.00	240,000.00
Monitorimi dhe vlerësimi	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Grantet/impakti Led/mbështetja	1,000,000.00	320,000.00	1,920,000.00
Mozaiku i Muzeut Historik Kombëtar	668,000.00	133,600.00	801,6000.00
Kisha e Manastirit Rubik	108,200.00	21,640.00	129,840.00
Kisha e Shën Andoninit në Rodon	89,100.00	17,820.00	106,920.00
Muzeu Etnografik Krujë	675,000.00	135,000.00	810,000.00
Ura Kurcaj	120,000.00	24,000.00	144,000.00
Torra Veneciane, Durrës	600,000.00	120,000.00	720,000.00
Muzeu Etnografik i Kavajës	600,000.00	120,000.00	720,000.00
Hamami i Durrësit	250,000.00	50,000.00	300,000.00
Teatri Kombëtar i Kukullave	2,650,000.00	520,000.00	3,120,000.00
Kalaja e Lezhës	1,500,000.00	300,000.00	1,800,000.00
Muzeu Arkeologjik, Durrës	2,650,000.00	530,000.00	3,180,000.00

Kalaja e Bashtovës	1,200,000.00	240,000.00	1,440,000.00
Muzeu Historik Kombëtar	14,000,000.00	2,800,000.00	16,800,000.00
Muzeu Etnografik i Durrësit	200,000.00	40,000.00	240,000.00
Kalaja e Ishmit dhe ndërtesa ngjitur kalasë	300,000.00	60,000.00	360,000.00
Akademia Kombëtare e Shkencave	380,000.00	76,000.00	456,000.00
Gërmadhat e Kishës së Shën Marisë	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Porto-Romano, Durrës	150,000.00	30,000.00	180,000.00
Biblioteka Kombëtare, Tiranë	700,000.00	140,000.00	840,000.00
Ndërtesa e Institucionit të ish-të Persekutuarve	300,000.00	60,000.00	360,000.00
Ish-Arqipeshkvia	250,000.00	50,000.00	300,00.00
Ish-Lidhja e Shkrimtarëve	250,000.00	50,000.00	300,000.00
Ministria e Kulturës	500,000.00	100,000.00	600,000.00
Galeria Kombëtare e Arteve	120,000.00	24,000.00	144,000.00
Fondi i Bibliotekës Kombëtare	360,000.00	72,000.00	432,000.00
Arkivi Kombëtar i Filmit	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Arkivi Teknik IKTK	200,000.00	40,000.00	240,000.00
Banesa Ahmet Cuni, Murrizë	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Selia Bashkimi, Tiranë	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Muzeu Etnografik Lezhë	250,000.00	50,000.00	300,000.00
Banesa Preng Lleshi	60,000.00	12,000.00	72,000.00
Shtëpitë brenda Kalasë së Krujës	450,000.00	90,000.00	540,000.00
UNOPS	5,008,600.00	0	5,008,600.00
TOTALI I GRANTIT	**40,0000,000.00**	**6,998,280.00**	**46,988,280.00**

Preventivi aktual total do të rishikohet me përfundimin e studimit dhe detajet e projekteve dhe pas finalizimit të prokurimeve.

SH. E TIJ AMBASADOR I BASHKIMIT EVROPIAN
Luigi Soreca

(nënshkrimi)

SH. E SAJ MINISTRE E KULTURËS

Elva Margariti

(nënshkrimi

KRYETARE E UNOPS-it
Dr. Pamela Lama

(nënshkrimi)

URDHËR
Nr. 32/3, datë 2.3.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 99, DATË 10.2.2021, "PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 986/1 prot., datë 2.3.2022,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 3.3.2022, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 155, datë 2.3.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 100, DATË 10.2.2021, "PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, *FAST FOOD* DHE LOKALEVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 986/1 prot., datë 2.3.2022,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 100, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, *fast food* dhe lokaleve", të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 3.3.2022, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 23, datë 14.2.2022

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES, MBI MASAT E TË LICENCUARVE NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT, PËR ARRITJEN E TREGUESVE TË MATJES DHE VLERËSIMIT NGA ERE TË PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT NDAJ KLIENTIT

Në mbështetje të nenit 10, nenit 16, nenit 18, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të nenit 25, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 204/4 prot., datë 7.2.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, "Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit",

konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 208, datë 8.10.2021, ERE ka filluar procedurën për miratimin e "Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit".

- Nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1003 prot., datë 18.10.2021, ERE ka ftuar palët e interesit të japin qëndrimin apo objeksionet dhe komentet e tyre, në lidhje me këtë draftrregullore.

- Janë identifikuar si palë interesi, për qëllime të kësaj praktike, të gjithë të licencuarit nga ERE në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike apo gaz natyror, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Ministria e

Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Avokati i Popullit (AP), Autoriteti i Konkurrencës (AK), Shoqatat e Konsumatorit (SHK), si dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE).

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën nr. 4299/1 prot., datë 17.11.2021, protokolluar me tonën nr. 1003/1 prot., është përgjigjur Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, e cila në lidhje me draftrregulloren është shprehur parimisht dakord.

- Me shkresën nr. 1003/2 prot., datë 1.12.2021, AAES-ja ka përcjellë në ERE qëndrimin e saj në lidhje me draftrregulloren, duke propozuar disa ndryshime në përmbajtjen e saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1003/3 prot., datë 9.12.2021, MIE ka bërë me dije se shprehet dakord për vijimin e procedurës nga ERE, në zbatim të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

- Me shkresën nr. 1003/4 prot., datë 13.12.2021, AK-ja ka bërë me dije se: "Kjo procedurë është në mbështetje të nenit 7, pika 1, 16 dhe 20, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 6, pika 3; 16, pika 18, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe të neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 17.6.2016. Nga vlerësimi i këtij vendimi AK-ja ka konstatuar se kjo procedurë nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 1003/5 prot., Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. ka përcjellë opinionin e tij në lidhje me draftrregulloren.

- Të gjitha opinionet e palëve, në lidhje me këtë draftrregullore, janë publikuar në faqen zyrtare të ERE-s, në zërin konsultime dhe janë njoftuar palët e interesit të vlerësojnë këto propozime.

- Nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1134 prot., datë 7.12.2021, është njoftuar organizimi i një seance dëgjimore me qëllim diskutimin në lidhje me propozimet e përcjella nga palët.

- Seanca është organizuar më datë 13.12.2021, me pjesëmarrje të ERE-s, AK-së dhe AAES-së.

- Me anë të shkresës nr. 1134/1 prot., datë 24.12.2021, ERE vijoi komunikimin me palët e interesit si më poshtë: FSHU sh.a., Avokati i Popullit, AAES, Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit, Shoqata Konsumatori në Fokus, Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit, Shoqata e Konsumatorit, AK, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë (CCIT), Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, të cilët u ftuan edhe njëherë për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të planifikuar për t'u organizuar nga ERE më datë 5.1.2022.

- Më datë 5.1.2022, datë e planifikuar për organizimin e seancës dëgjimore nëpërmjet platformës së komunikimit ZOOM, u paraqit vetëm Autoriteti i Konkurrencës, i cili kishte shprehur edhe më herët qëndrimin e tij, në lidhje me vetë draftrregulloren e propozuar nga ERE, por edhe propozimet e palëve të interesit.

- AAES-ja ka propozuar që në nenet 1.2/a, 1.2/b, 1.2/e, 1.2/f, 1.2/h, 1.2/j, në fund të paragrafit të shtohet: "(e aplikueshme vetëm për furnizuesit që furnizojnë klientë fundorë të lidhur në tension të ulët, si dhe për furnizuesit që furnizojnë më shumë se 100 klientë fundorë)".

- Detyrimet e mësipërme, të cilat të gjithë furnizuesit e licencuar i kanë marrë përsipër t'i përmbushin pas marrjes së licencës për ushtrimin e aktivitetit nga ERE, janë detyrime që lidhen me informimin e klientëve/konsumatorëve mbi të drejtat e mundësitë që ligji u garanton këtyre të fundit në mënyrë të barabartë e jodiskriminuese. Për sa më sipër, propozimi i AAES-së për përjashtimin e furnizuesve që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në konsumatorë të lidhur në tension të mesëm e të ulët, bie ndesh me sa garantuar nga ligji për këta të fundit, por edhe nga aktet rregullatore që ERE ka miratuar për këtë qëllim.

- AAES-ja ka propozuar që në nenet 2.1, 2.2, 4.1, 4.2, në fund të paragrafëve të këtyre dispozitave të shtohet: "(e aplikueshme vetëm për furnizuesit që furnizojnë klientë fundorë të lidhur në tension të ulët, si dhe për furnizuesit që furnizojnë më shumë se 100 klientë fundorë)".

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nuk parashikon një ndarje të të licencuarve në aktivitetin e furnizimit sipas nivelit të tensionit në të cilin janë lidhur konsumatorët që ata furnizojnë, por orienton në parimet e tij të përgjithshme drejt trajtimit të barabartë e jodiskriminues të të gjithë pjesëmarrësve të tregut e

mbi të gjitha mbrojtjen e konsumatorit. Për sa më sipër, propozimi i AAES-së, për përjashtimin e furnizuesve që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në konsumatorë të lidhur në tension të mesëm e të ulët, bie ndesh me sa garantuar nga ligji për këta të fundit, por edhe nga aktet rregullatore që ERE ka miratuar për këtë qëllim.

- AAES-ja ka propozuar që në nenin 5.1 të reflektohet ndryshimi: Furnizuesi (nëse dhe kur e aplikueshme) do të përgatisë informacione periodike çdo 6 muaj për të informuar ERE-n mbi nivelin e sigurimit të shërbimeve, siç përcaktohet në këtë rregullore. Propozimi i mësipërm i AAES-së, në kushtet e rrëzimit të kërkesave për shtesat e sipërcituara, është i paaplikueshëm, ndaj si i tillë nuk pranohet.

- Nga ana tjetër, AAES-ja ka propozuar, gjithashtu, që për të akomoduar dhe rastet e furnizuesve që nuk kryejnë furnizime gjatë një viti kalendarik, pas nenit 7, të shtohet neni 8, me këtë përmbajte: Në nenin 8, kjo rregullore nuk aplikohet për furnizuesit të cilët, gjatë një viti kalendarik, nuk kanë furnizuar asnjë klient fundor (në lidhje me këtë propozim, dispozitën e shtuar e gjejmë pjesërisht të drejtë duke vlerësuar si të drejtë vetëm sa i përket përmbushjes së detyrimeve për raportim në ERE, në lidhje me treguesit e arritur).

- Kërkesa pranohet pjesërisht, duke riformuluar dispozitën si vijon: Kjo rregullore nuk aplikohet për furnizuesit të cilët, gjatë një viti kalendarik, nuk kanë furnizuar asnjë klient fundor. Në çdo rast furnizuesit që vendosin të ushtrojnë aktivitetin e furnizimit njoftojnë ERE-n për masat e marra, për garantimin e përmbushjes së kushteve të kësaj rregulloreje, jo më vonë se 15 ditë nga fillimi i ushtrimit të aktivitetit të furnizimit për klientët fundorë.

- FSHU sh.a. ka propozuar që në paragrafin hyrës të hiqet fjala "urdhrave". Propozimi i mësipërm pranohet pjesërisht, duke zëvendësuar fjalën "Urdhrat" me "Urdhërimet".

- FSHU sh.a. ka propozuar që në nenin 3, pika 4, fjala "zgjidhje" të zëvendësohet me "trajtim". Kuadri rregullator në fuqi ka vendosur detyrime për zgjidhjen dhe jo vetëm trajtimin e ankesës së konsumatorit nga ana e furnizuesve, ndaj propozimi i mësipërm nuk pranohet.

- FSHU sh.a. ka propozuar që në nenin 4, parashikimet mbi monitorimin dhe raportimin të reflektohen edhe në vendimin nr. 217, datë 15.12.2020, "Mbi rishikimin e planit të masave për OSHEE-në, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 3.9.2018. Propozimi i FSHU sh.a. pranohet e për këtë qëllim propozojmë shtesën në pikën 8, të kësaj rregulloreje, me përmbajtje: "Kushtet dhe afatet e raportimit në ERE, të përmbushjes së parashikimeve të kësaj rregulloreje, për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal, janë ato të parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 3.9.2018, "Plani i masave për Furnizuesin e Shërbimit Universal, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e "Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit, për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit" (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.6.2022, efektet për qëllime të raportimit të parë përfshijnë periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2022, dhe efektet juridike fillojnë në janar 2023.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23 datë 14.2.2022

RREGULLORE
MBI MASAT E TË LICENCUARVE NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PËR ARRITJEN E TREGUESVE TË MATJES DHE VLERËSIMIT NGA ERE TË PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT NDAJ KLIENTIT

Hyrje

Në zbatim të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE ka të drejtën dhe detyrën për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e operatorëve të licencuar, në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore, si dhe zbatimin e vendimeve dhe urdhërimeve të ERE-s.

Vizioni i ERE-s është për një treg të hapur dhe konkurrues, ku klientët mbrohen dhe marrin shërbim të sigurt dhe brenda cilësisë së miratuar nga ERE. Duke u ofruar konsumatorëve informacion dhe duke u ofruar atyre mundësi se si ata mund të marrin pjesë në tregun e energjisë, ata do të mbrohen më mirë.

Qëllimi i ERE-s për mbrojtjen e klientit

Autoriteti i ERE-s për mbrojtjen e klientit ka si qëllim:

- Mbrojtjen e interesave të klientëve në tërësi, bazuar në një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues përmes procedurave ligjore e transparente;
- Monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i licencuari ndaj klientëve të energjisë elektrike;
- Të promovojë përfitimet e konkurrencës dhe të mbrojtjes së klientit përmes ndërgjegjësimit publik;
- Të informojë klientët për të bërë zgjedhje mbi bazën e informacionit të siguruar, për të mbështetur kështu të drejtat e tyre, përfshirë të drejtën e zgjedhjes së furnizuesit të energjisë elektrike.

Neni 1
Përgjegjësitë e furnizuesit sipas kuadrit rregullator

1.1 Informimi i klientëve për të drejtat e tyre

ERE, në përputhje me autoritetin sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike, në çdo kohë, do të kontrollojë mbi nivelin e informimit të klientëve për të drejtat e tyre. Është përgjegjësi e furnizuesit t'u ofrojë konsumatorëve qasje në informacionin që lidhet me shërbimin e ofruar nga i licencuari. Sa më sipër, detyrimi i çdo furnizuesi konsiston në:

a) të informimojë klientët për të drejtat dhe kushtet me të cilat do të furnizohet;

b) të informimojë klientët për çmimet e furnizimit me energji elektrike për periudhën e ofruar;

c) të informimojë klientët që kanë të drejtën të zgjedhin një furnizues tjetër, në përputhje me rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike;

d) të informimojë klientët mbi mjetet e disponueshme për të shlyer detyrimet e papaguara;

e) të informimojë klientët për kriteret e ndërprerjes së furnizimit të "klientëve në nevojë", sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, "Rregullores mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë" dhe legjislacionit përkatës në vend;

f) të informimojë klientët mbi standardet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

1.2 Masat për përmbushjen e detyrimit për informim

Veprimet në kuadër të detyrimit të furnizuesit për informim, përfshijnë:

a) detyrimin e furnizuesit për dhënien e informacionit përmes shërbimeve telefonike dhe në çdo formë tjetër, me qëllim kryerjen e njoftimeve publike për të ofruar një shërbim të dobishëm, të sjellshëm dhe efektiv për të gjithë klientët;

b) furnizuesi do të sigurojë vënien në dispozicion në faqen e tij të internetit, si dhe në çdo qendër të kujdesit ndaj klientit (KNK) dhe në kopje të shtypura, sipas kërkesës së klientit, informacionin mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit;

c) furnizuesi është përgjegjës për të siguruar që i gjithë stafi të jetë i vetëdijshëm dhe t'i përmbahet

detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi;

d) të sigurojë auditim të brendshëm të performancës së shërbimit të klientit, jo më pak se 1 herë në vit;

e) furnizuesi do të mundësojë marrjen e komenteve nga klientët për shërbimin e ofruar (anketa dhe forma të tjera të përshtatshme sipas furnizuesit) dhe do të dokumentojë garantimin e kësaj detyre në formën e përzgjedhur nga furnizuesi;

f) të përcjellë në ERE, jo më vonë se data 31 janar e vitit pasardhës, analizën e tij mbi anketat e vlerësimit të shërbimit nga klientët, si dhe të bëjë me dije masat e planifikuara për të përmirësuar shërbimin aty ku është e mundur;

g) furnizuesi duhet të sigurojë që personat që kanë aftësi të kufizuara të mund të aksesojnë lehtësisht shërbimet e ofruara nga furnizuesi;

h) furnizuesi duhet të sigurohet që qendrat e kujdesit të klientit të jenë të disponueshme për shërbimin e klientëve, në përputhje me orarin e njoftuar të shërbimeve;

i) furnizuesi duhet të sigurojë dhënien e informacioni të qartë, në kohë, të saktë, e që është në dispozicion në të gjitha pikat e kontaktit edhe nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit;

j) furnizuesi duhet të përgatisë formularë, fletëpalosje që përmbajnë informacion mbi shërbimin e furnizimit apo ofertat, duke siguruar informacion në gjuhë të thjeshtë që kuptohet lehtë;

k) furnizuesi duhet të sigurojë linja telefonike për sigurimin e informacionit dhe me qëllim që të informojë klientët duke iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me të drejtat e përgjithshme të klientit, si dhe shërbimet e ofruara.

1.3 I licencuari, në çdo rast, ka detyrimin të ruajë e përpunojë të dhënat e siguruara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Neni 2
Veprimet në kuadër të detyrimit për akses në shërbime

1. Furnizuesi duhet të vendosë një sistem regjistrimi të telefonatave që administrohen nga qendrat e kujdesit të klientit dhe të ruajë të dhënat, për një periudhë jo më të shkurtër se 30 ditë nga data e regjistrimit.

2. Furnizuesi duhet të përgatisë raporte periodike, mbi sigurimin e dhënies së informacionit përmes linjave telefonike apo internetit, dhe sipas rastit të kryejë auditime për shërbimin e klientit, nivelin e informacionit të ofruar në qendrat e kujdesit ndaj klientit (KNK). Raportet periodike t'i bëhen me dije ERE-s, jo më vonë se data 31 dhjetor e çdo viti kalendarik.

Neni 3
Ankesat

1. Furnizuesi do të regjistrojë çdo ankesë të adresuar pranë tij në një nga format e dokumentueshme dhe do të mbajë klientët të azhurnuar, duke siguruar informacion në lidhje me ankesën e tyre në baza të vazhdueshme, në një nga format e gjurmueshme të komunikimit.

2. Furnizuesi do të mbajë një sistem zyrtar të regjistrimit të ankimit/rishikimit të formalizuar, transparent dhe të thjeshtë për përdorim, për të gjithë klientët, të cilët janë të pakënaqur në lidhje me shërbimet.

3. Nëse klienti nuk është i kënaqur me rezultatin e ankesës fillestare, duhet të informohet nga furnizuesi për të drejtën e tij për të ankimuar qëndrimin e furnizuesit në institucionet e ngarkuara me ligj për mbrojtjen e klientit, të tilla si: ERE, Zyra e Avokatit të Popullit, Komisioni për Mbrojtjen e Klientit etj.

4. Furnizuesi duhet të sigurohet se stafi është i vetëdijshëm për procesin e ankesave, pranon ankesën dhe merr të gjitha masat për ta zgjidhur atë brenda afateve.

5. Furnizuesi do të bëjë me dije ERE-n, jo më vonë se data 31 janar e çdo viti kalendarik, në lidhje me ankesat e regjistruara, si dhe afatet e procedurat e trajtimit të tyre, në përputhje me parashikimet e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60/2021.

Neni 4
Monitorimi dhe raportimi

1. Furnizuesi do të zhvillojë një anketë të shërbimit të klientit, si një tregues i performancës

në 3-mujorin e parë të çdo viti kalendarik. Lloji dhe numri i klientëve që do të anketohen do të përcaktohet nga furnizuesi. Rezultatet e kësaj ankete do të publikohen në faqen zyrtare të furnizuesit, si dhe do të raportohen në ERE jo më vonë se data 31 dhjetor e çdo viti.

2. Pas mbledhjes dhe analizimit të rezultateve të anketimit, furnizuesi, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, do të hartojë një plan veprimi të ri, kopje të të cilit përcjell për dijeni në ERE, i cili do të përqendrohet në fushat për përmirësim të rezultateve, dhe progresi kundrejt standardeve të vendosura. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal ka detyrimin e përcjelljes për miratim në ERE të planit të veprimit, sipërcituar.

3. ERE do të kryejë monitorime specifike, në lidhje me:

a) trajtimin dhe statusin e ankesave;

b) procedurën e ndjekur nga qendrat e kujdesit ndaj klientit, për trajtimin e ankesave të klientëve të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60/2021;

c) zbatimin e afateve lidhur me lëshimin e faturës së korrektuar dhe kompensimet përkatëse sipas treguesve të cilësisë së shërbimit, konform "Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar;

d) kushtet e punës së qendrave të kujdesit të klientit;

e) eficiencën në dhënien e shërbimeve;

f) transparencën në dhënien e informacionit të domosdoshëm për klientët;

g) afishimin dhe publikimin e të dhënave të domosdoshme për klientët, që lidhen kryesisht me:

afatet dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e tij me klientët në të gjitha zyrat e tij, publikimi në faqen e tij të internetit, dhe vënia në disponim të klientëve të një kopje të dokumentit;

h) marrjen e informacionit të detajuar mbi çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike për kategori të ndryshme klientësh;

i) të drejtën për të ndryshuar furnizues;

j) të drejtën për të ushtruar ankim;

k) lëshimin e faturave të detajuara, sipas kërkesës, dhe mbajtjen e dokumentacionit të mjaftueshëm për të mbështetur shumat e faturuara;

l) ngritjen dhe menaxhimin e njësive të dedikuara për marrëdhëniet me klientët, dhe punësimin e një numri të mjaftueshëm personeli të kualifikuar;

m) publikimin e të dhënave mbi organizimin e njësisë së dedikuar, përfshirë vendndodhjen, orët e punës, orët për takimet me klientët, numrin e telefonit të kontaktit, afatet dhe kushtet për lidhjen e klientëve me rrjetin, aplikimet për hetimin e kushteve dhe procedurave për lidhjen e klientëve me rrjetin;

n) funksionimin e sistemit për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave, aplikimeve dhe propozimeve të klientëve.

Neni 5
Raportimet periodike

1. Furnizuesi do të përgatisë informacione periodike, çdo 6 muaj, për të informuar ERE-n mbi nivelin e sigurimit të shërbimeve, siç përcaktohet në këtë rregullore. Informacioni periodik do të përfshijë, ndër të tjera, raportim mbi:

a) njohjen e stafit me përgjegjësitë e të licencuarit, duke siguruar që i gjithë stafi të jetë i vetëdijshëm dhe t'u përmbahet detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi;

b) auditimin e shërbimit të klientit;

c) analizën e komenteve nga klientët për shërbimin e ofruar (anketa dhe forma të tjera të përtashme sipas furnizuesit);

d) vlerësimet në analizë të gjetjeve nga komentet e klientëve;

e) çështje të tjera në gjykimin e furnizuesit, që lidhen me respektimin e të drejtave të klientëve.

Neni 6
Treguesit e vlerësueshëm të shërbimit

1. Furnizuesi duhet të sigurojë një numër të mjaftueshëm punonjësish të kujdesit të klientit për të përmbushur me eficiencë masat e parashikuara në këtë dokument. ERE ka të drejtë të rekomandojë rekrutimin e një numri më të madh punonjësish nëse konstaton se një numër i ulët punonjësish cenon cilësinë e shërbimit të klientit.

2. Furnizuesi duhet të planifikojë e të bëjë me dije ERE-n, jo më vonë se 31 janari i çdo viti pasardhës, në lidhje me:

a) numrin e klientëve për punonjës;

b) shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes për klient;

c) shpenzimet e furnizimit me energji elektrike për kwh;

d) shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes për kwh të shitura;

e) shpenzimet e furnizimit me energji elektrike për kwh të shitur;

f) shpenzimet administrative dhe të përgjithshme për klient;

g) kohën mesatare të përgjigjes ndaj kërkesave dhe ankesave;

h) numrin e klientëve që rikthehen për të marrë shërbim;

i) numrin e ndërprerjeve në vit dhe numrin e orëve/ditëve të vonesës në marrjen e lidhjes së energjisë;

j) afatet e mbledhjes së detyrimeve financiare nga klientët.

3. Informacioni periodik i dërguar nga furnizuesi, siç përcaktohet në këtë dokument, dhe gjetjet e evidentuara në informacionin e përgatitur nga stafi teknik i ERE-s, nga monitorimet specifike siç cituar më lart, do të shërbejnë për vlerësimin nga ERE të ofrimit të shërbimeve dhe sigurimin e respektimit të të drejtave të klientëve nga furnizuesi.

4. ERE do të vlerësojë performancën e shërbimit ndaj klientit të të licencuarve në aktivitetin e furnizimit, jo më pak se çdo 3 vjet.

5. Në rast se ERE konstaton se performanca e një të licencuari në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit është jo e mirë, do të përgatisë qëndrimin e tij, dhe pas marrjes së objeksioneve të furnizuesit, në lidhje me gjetjet e ERE-s, mund të dalë me vendim të Bordit për lënien e detyrave dhe afateve për plotësimin e tyre.

6. Në rast se i licencuari nuk merr masat e nevojshme në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 5, të kësaj rregulloreje, si dhe detyrimeve për raportim në ERE, siç parashikuar në nenin 5 të kësaj rregullore, ERE mund të marrë masa ndaj të licencuarit, në përputhje me parashikimet e "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave".

Neni 7

Kritere të vlerësimit të performancës

1. Performanca e furnizuesit në cilësinë e shërbimit do të konsiderohet:

a) e mirë, nëse ka më pak se 3% të totalit të klientëve që kanë ushtruar ankim,] në lidhje me keqfaturimin;

b) e kënaqshme, nëse ka 3 % të totalit të klientëve që kanë ushtruar ankim në lidhje me keqfaturimin;

c) jo e mirë, nëse ka më shumë se 3% të totalit të klientëve që kanë ushtruar ankim në lidhje me keqfaturimin.

2. Performanca e furnizuesit në trajtimin e ankesave do të konsiderohet:

a) e mirë, nëse ankesat janë trajtuar para afatit të parashikuar në rregullore;

b) e kënaqshme, nëse ankesat janë trajtuar në afatin e parashikuar në rregullore;

c) jo e mirë, nëse ankesat janë trajtuar jashtë afatit të parashikuar në rregullore.

3. Performanca e furnizuesit në kohën e përgjigjes ndaj kërkesave të klientit do të konsiderohet:

a) e mirë, nëse furnizuesi ka marrë të gjitha masat teknike/organizative të cituara në këtë rregullore për adresimin në kohë të kërkesave/ ankesave pranë furnizuesit;

b) e kënaqshme, nëse furnizuesi ka marrë disa nga masat teknike/organizative të cituara në këtë rregullore për adresimin në kohë të kërkesave/ ankesave pranë furnizuesit, por pa cenuar cilësinë e shërbimit;

c) jo e mirë, nëse furnizuesi nuk ka marrë masat teknike/organizative, të cituara në këtë rregullore, për adresimin në kohë të kërkesave/ankesave pranë furnizuesit duke cenuar cilësinë e shërbimit.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

1. Kjo rregullore nuk aplikohet për furnizuesit të cilët, gjatë një viti kalendarik, nuk kanë furnizuar asnjë klient fundor. Në çdo rast, furnizuesit që vendosin të ushtrojnë aktivitetin e furnizimit njoftojnë ERE-n për masat e marra, për garantimin

e përmbushjes së kushteve të kësaj rregulloreje, jo më vonë se 15 ditë nga fillimi i ushtrimit të aktivitetit të furnizimit për klientët fundorë.

2. Afatet e raportimit në ERE, të përmbushjes së parashikimeve të kësaj rregulloreje, për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal, janë ato të parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, data 3.9.2018, "Plani i masave për Furnizuesin e Shërbimit Universal, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike".

3. Kjo rregullore është objekt rishikimi me vendim të Bordit të ERE-s, pas kërkesës së palëve të interesit ose me iniciativë të ERE-s.

KËRKESË

Shtetaset Polikseni Samarxhiu dhe Krisanthi Qiriako kërkojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër vërtetimin e faktit juridik të vdekjes së shtetases shqiptare Aristulla Stamati.

KËRKUESE
Polikseni Samarxhiu
Krisanthi Qiriako

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 37
Datë: 2022/03/09 16:24:16
b25c0cfd-2690-4858-a916-fe0461924bd0

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë